

Analistët
Qytetarët pasiv,
politikanët jo
vetëkritikë

Fq.3



YLBER HYSA
Përveç NATO-s,
aleancat
tjera kërcënojnë
sigurinë


Fq.4



Manuel Nojer

Kësaj
Gjermanie
nuk i
trembej kush

Fq.22



Koha

www.koha.mk

**Rrugë
të qartë
drejt BE-së**

Fq.3



E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3400 · E premte, 29 qershor 2018

15°C | 23°C

15 DEN

FORUM

**Beyonce,
shqiponja
dhe birra!**



Të qenurit në media dhe pranë saj, produktet mediatike mbase më tërheqin por dhe analiza mbi to mund të mos jetë tipike. Dhe dua të flas sot për tre produkte dhe fenomene që i shoh në media e që në të gjitha rastet edhe pse s'kanë asgjë me njëra-tjetrën i lidh fuqishëm...

Fq.10

RAJON

**Stop për
Vulinin**

Fq.14

MOZAIK

**Gijotina,
shpikja që lau
me gjak
Revolucionin**

Fq.13

EDITORIAL

**Europa si
botëkuptim
apo si
teknikalitet?**

Fq.2



NGA VITI SHKOLLOR 2007/2008 DERI 2017/2018

30 MIJË NXËNËS MË PAK



Rënia prej rreth 30 mijë nxënës në periudhën e viteve 2007-2017, nga njëra anë dhe në anën tjetër rritje për rreth 3 mijë mësimdhënës në të njëjtin hark kohor, ka përmirësuar performancën e raporteve mësimdhënës/nxënës në nivel shteti. Mirëpo, pavarësisht kësaj, në shumë komuna kanë mbetur të hapura problemet me mbingarkesën e shkollave me paralele dhe numër të lartë nxënësish në klasë, sikurse është rasti me shkollat e Çairit

Fq.6

Subvencione më të larta për domatet dhe pemët

Shkup, 28 qershor - Ministria e Bujqësisë me rritjen e subvencioneve për domatet dhe pemët e grumbulluara, si dhe me blerjen e 12 mijë tonë të grurit për rezervat shtetërore, pritet të zbusë dukshëm problemet me shitblerjen dhe çmimet e ulëta të pemë-perimeve në shtet. Njëherësh, po ndërmerren edhe aktivitete për rritjen e plasmanit të prodhimeve bujqësore nga Maqedonia jashtë shtetit, si dhe

për hapjen e qendrave grumbulluese dhe distributive. Me vendimet e fundit qeveritare, prej sivjet rriten subvencionet për pemët e dorëzuara në industrinë përpunuese prej dy në tre denarë. Rriten edhe subvencionet prej tre në shtatë denarë për kilogram domatesh të dorëzuara në kapacitetet prodhuese. Subvencionet pritet të ndihmojnë prodhuesit jo vetëm të pjeshkave në Rosoman...

Fq.7



EDITORIAL

EUROPA SI BOTËKUPTIM APO SI TEKNIKALITET?



Emin AZEMI

Pas paralajmërimit për hapjen e negociatave me BE-në në qershor të vitit të ardhshëm, kishte një bashkëshoqërim reagimesh e qasjesh nga më të ndryshmet. Por, si zakonisht, po ndodhë edhe një heshtje e përgjithshme e shoqërisë shqiptare dhe kjo sjellje të krijon idenë sikur kjo shoqëri është disi e ndarë, që nuk korrespondon me realitetin e përgjithshëm dhe reagimet i bën pa ndjesinë e tërësisë. Askush, pra, s'po na tregon se si do të bëhemi pjesë e Europës, pas fillimit të negociatave për anëtarësim në BE. Do të donim ta dënim me cilat kritere do të matet meritokracia në shoqërinë shqiptare dhe si do të zhvillohet botëkuptimësia rreth formimit intelektual, profesional e qytetar të elitave që do ta udhëheqin këtë shoqëri. Në BE a do të shkojmë me gjithë këto universitete që më shumë prodhojnë diploma, se sa përgatisin kuadro për treg, me gjithë këta tituj akademikë, që më shumë harxhojnë energji për të gjet lidhje për punësim, se sa që shkruajnë ndonjë punim shkencor, me gjithë këtë diversitet brendafetar, që më shumë prodhon konfuzitet, se sa kthjelltësi mendimi e vizioni, me gjithë këtë armatë të rinjsh, të cilët më shumë angazhohen për të gjetur ndonjë punë në Mc'Donalds në Gjermani, se sa të marrin mundin të aplikojnë për ndonjë vend pune në vendlindje, me gjithë këtë tokë bujqësore që në vend se të punohet për të siguruar bukën, dita ditës po shndërrohet në djerrinë me thera gomari?

Proceset eurointegruese janë kuptuar gabimisht si obligime që iu takojnë vetëm politikanëve. Mirëpo askush nuk po mendon se nesër, sigurisht pas dhjetë vjetëve, kur të bëhemi pjesë e BE-së, sa do të jemi konkurrues me vendet tjera dhe a do të skuqemi nëse nuk e përmirësojmë cilësinë e arsimit, kulturës, politikbërjes, ekonomisë etj. Pse ka nevojë të flasim me këtë gjuhë kaq të ngatërruar burokratike që nënkupton demokracia reforma të ndryshme në gjyqësor, në administratë, në politikbërje dhe nuk jemi në gjendje të japim përgjigje në një pyetje të thjeshtë: Jemi apo s'jemi si shoqëri në gjendje të bëjmë një rishqyrtim të brendshëm për të skanuar dobësitë tona, pa të cilat do të ishim më të pranueshëm në një rreth të gjerë vlerash e kulturash. Shqiptarët, si rëndomë, e kanë shumë problem të flasin për dobësitë e tyre, sepse ata mendojnë se edhe nëse e kanë ndonjë behane, fajet i kanë të tjetër. Por, shqiptarët harrojnë se për shumë vite (më shumë se dy dekada) janë drejtues të disa fushave në arsim, kulturë, politikë, ekonomi dhe dinamika e zhvillimit për shumë çka është varur nga vetë shqiptarët. Në pjesën dërmuese të shkollave dhe universiteteve kanë qenë shqiptarë, në pjesën dërmuese të komunave në Maqedoninë Veriperëndimore kanë qenë shqiptarë, në çdo qeveri ka pasur partnerë shqiptarë të koalicionit, mirëpo shumë pak flasim për bilancet e projektuara si rezultat i të qenit të shqiptarëve bartës të punëve drejtuese në të gjitha këto fusha. Rezultatet testuese që dalin çdo vit, madje edhe prej subjekteve ndërkombëtare, tregojnë se shkollat dhe universitetet tona (me ndonjë përjashtim) janë në fund të pusit. Ankesat që vijnë prej banorëve, por edhe prej mërgimtarëve, janë të dominuara me kritika drejtuar pushteteve lokale për situatën katastrofike në fushën e investimeve, ruajtjen e ambientit, në shumëzimin e deponime të egra, në kultivimin e "fermave të egra" me qenë endacakë, që barten nga njëra komunë në tjetër, si dhe në mosofrimin e projekteve konkrete që do t'i nxirrin këto rajone nga harta e viseve me zhvillim joproportional.

Pse proceset eurointegruese janë kuptuar si një udhëtim i thjeshtë turistik dhe pse shqiptarët mendojnë se tjetër kush, e jo ata, duhet të kujdesen për imazhin e tyre, për sensin e tyre në zgjedhjen e elitave politike e kulturore, për vendosjen e raporteve në nivele të barabartë bashkëpunimi me bashkëqytetarët maqedonas dhe për fokusimin e energjive që sjellin ndryshime kolektive e jo personale.

Europa ka qenë dhe do të jetë gjeografikisht aty ku është, por kulturalisht dhe psikologjikisht nuk është aty ku dikush e barazon atë me një destinacion pikniku. Europa, mbi të gjitha është filozofi dhe botëkuptim. Gjithçka tjetër është teknikalitet.

NË MBROJTJE TË XHABIR ZHARKUT

"Ditën kur Xhabir Zharku, në cilësinë e kryetarit të Kaçanikut, një komune ngjitur me malin e Sharrit, vendosi që shëtitorja rreth lumit Lepenc duhej të mbillej me palma, me gjithë kritikën dhe përqeshjet adresuar atij, bëri një veprim logjik. Ata që e sulmuan dhe përqeshen vunë në pah se Kaçaniku ka një klimë bukur të ashpër në dimër, se ka edhe ngrica të mëdha, dhe se nuk kishte vend në Kosovë ku mund të mbillej palma - as në vende më të ngrohta si Prizreni e Gjakova, e lëre më një qytezë malore si Kaçaniku - pra, se palmat do të ishin një dështim i madh. Por, a nuk ishte thënë kështu edhe për veprimet e mëhershme të Zharkut dhe shokëve të tij?"

A nuk thuhet se këta "marksistë-leninistë" nuk dinin gjë prej gjëje, se ishin vegël e Sigurimit të Shqipërisë?

Por, atëherë, a nuk ndodhi që Zharku dhe shokët e tij e çliruan Kosovën dhe ashtu të lirë ia lënë në duar NATO-s dhe pranisë civile ndërkombëtare? A nuk ndodhi që vetë Zharku, për të cilin jepeshin përkrahime të një personi rigjid dhe të dhunshëm, të zgjidhej kryetar i komunës me votat e qytetarëve?

Pra, a nuk është atëherë logjike që të gjitha ato që dukeshin të palogjikshme dhe të pazëshme - prej faktit se Xhabir Zharku çliroi Kosovën, Hashim Thaçi u bë kryeministër e president, dhe palmat u mbollën në Kaçanik - të jenë në fakt të logjikshme dhe të bëshme?," shkruan në profilin e tij në FB, publicisti Veton Surroi.

SHQIPTARI I ZI

"Shqiptari i zi, me biletën e llotos në xhep, sa herë fiton ndonjë vend i vogël mendon se loja është shitur te kompanitë e basteve. Sipas shqiptarit vetëm vendet e mëdha munden, të voglat s'munden kurrë vetë të bëjnë asgjë për së mbari. Edhe nëse bëjnë diçka ndonjëherë, ka mbrapa një hile, prapë prej ndonjë fuqie të madhe. Ky botëkuptim është i domosdoshëm për të justifikuar të qenit rehat me mosbërritjen e asgjëje. Jemi të vegjël, pra është e kotë, thotë shqiptari i zi", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti Arbër Zaimi.

MEDIA Citate

KOSOVA E 1.798.506 BANORËVE

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar vlerësimin mbi numrin e banorëve për vitin 2017. Sipas këtij vlerësimi, në vitin 2017 popullsia e Kosovës pati një rritje natyrore për 20 406, ose, shprehur në përqindje, u rrit për 1.13%. Gjatë vitit 2017 është vlerësuar se 9 376 persona kanë ndërruar vendbanimin (komunën) e tyre. Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2017 ishte (-5 431 banorë). Popullsia rezidente e Kosovës, për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2017 u rrit për 14 975 banorë, ose 0.84%. Popullsia në Kosovë për vitin 2017 vlerësohet të jetë 1 798 506 banorë rezidentë.

(Koha Ditore, 28 qershor)

BASHKIA I HAP DYER MACEVE

Macet shpesh janë kafshë të përkëdhelura shtëpiake. Për ta në Turqi janë bërë edhe hotele, ndërsa ulen edhe në bankat shkollore. Mirëpo, punonjësit e Bashkisë Esenkoy në qarkun Yalova të Turqisë kanë shkruar një hap më tej duke ua hapur dyert e institucionet maceve. Kështu, tani këta kafshë të përkëdhelura me punonjësit e bashkisë ndajnë zyret, tavolinat e madje edhe kolltuqet. Punonjësit e bashkisë gati dy vite ushqejnë macet dhe u kushtojnë vëmendje të posaçme që të mos i zgjojnë derisa janë duke fjetur. Numri i maceve në bashki ndryshon. Në periudhën e verës janë më pak, kurse gjatë dimrit në bashki ka rreth 20 mace. Cigdem Ucar, drejtoreshë në njërin nga departamentet e bashkisë, tha se është një ndjenjë e mirë të ndash hapësirën me mace. Ucar shton se dy vite më parë kanë filluar të kujdesen për macet dhe pesë klyshët e tyre të vendosur para derës së bashkisë. "U dërgoja ushqim përjashta. Deri në fund të verës kanë mbetur dy klyshë. Me afrimin e dimrit, ato filluan të hynin me mua në ndërtesë. Pastaj më ndiqnin deri në zyrë. Fillova t'i ushqej aty", sqaron ajo. (Anadolu Agency, 28 qershor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KA PATUR URË GJIGANDE NË TEPELENË?

Është e vërtetë që poshtë kështjellës së Tepelenës ruhen gjurmë të një ure të madhe, pjesa e parë me harqe të shekullit të dytë. Pesë fazat e tjera janë ngritur nga shekulli VI deri XIX. Ajo u shkatërrua nga pushtuesit osmanë në 1492. Në vitin 1492 ndaloi në Tepelene për 24 dite, ekspedita ndëshkimore e sulltan Bajazitit të II.

Në shekullin XVII Tepelena kishte 250 shtëpi. Me 1789 Tepelenën e shtiu në dore Ali Tepelena, nga ku mori dhe emrin. Kalaja aktuale u rindërtua prej tij më 1819 me një sipërfaqe 4-5 ha me tre hyrje dhe 3 kulla. Deri

më 1820 ka qenë rezidenca e dytë e Pashait. Kalaja e ndërtuar nga Ali Pasha për të rrethuar sarajet e tij është monumenti më i rëndësishëm në Tepelene. Me sipërfaqe 4.5 hektarë, ajo u ndërtua në vitin 1819. Nëse hidhet vështrimin mbi Vjosë nga Kalaja do shohësh një tjetër urë këmbësore mbi lumë, e cila mbështetet mbi shtylla mjaft të vjetra prej guri. Ura origjinale u ndërtua nga Ali Pasha si një dhuratë për qytetin. Ura mund të kalohet duke ju çuar në fshatin Beçisht, vendlindja e Ali Pashës. Mbeturinat e shtëpisë së tij mund të shihen edhe sot.

ARDHMËRIA E MAQEDONISË NË SYTË E ANALISTËVE

QYTETARËT PASIV, POLITIKANËT JO VETËKRITIKË



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 28 qershor - Reforma në Gjyqësor ishte nyja kryesore e rekomandimit të kushtëzuar të Këshillit të Bashkimit Evropian për Maqedoninë dhe Shqipërinë. Qeveritë e të dyja vendeve proklamojnë se ishte pozitiv ky rekomandim.

Nga ana tjetër analistë politik dhe ekspert juridik mendojnë të kundërtën. Alajdin Demiri flet me tone negative ndaj qeveritarëve në Shqipëri dhe Maqedoni të cilët siç thotë ai nuk i kanë plotësuar deri më tani kushtet kryesore për të hapur negociatat me BE-në.

"Rekomandimi i fundit i Këshillit Evropian ishte mjaft i qartë dhe preciz duke vënë këto kushte, reformën në gjyqësor, të luftohet krimi dhe të luftohet korrupsioni. Kjo do të thotë se këto kushte nuk janë plotësuar. Elitave politike i jepet kohë 12 muaj që të veprojnë në këtë drejtim", thotë Alajdin Demiri. Por nëse e analizojmë më thellë, shton ai, elitat politike në Shqipëri dhe Maqedoni duhet të luftojë kundër vetes. "Do të thotë se politikanët duhet të bëjnë gjykatën e pavarur e cila do të ndjek krimin dhe korrupsionin e po këtyre qeverive si dhe atyre të kaluara. Kjo është logjika politike që duhet ndjekur, rrugë tjetër nuk ka për në BE", mendon Alajdin Demiri.

Elitat tona politike si zakonisht rekomandimin e cilësojnë si pozitiv ndërkohë që ai ishte negativ. "Qeveritaret tanë çka është më e keqja e lexojnë reformën në gjyqësi si nevojë të BE-së, e jo si nevojë tonë, prandaj kemi ngecje dhe pasiguri e mos besim të BE ndaj nesh", thotë Alajdin Demiri.

Se Maqedonia ka problem themelor me zbatimin e ligjit dhe luftimin e korrupsionit e thotë dhe Profesori Universitar Bashkim Selmani. "Është shumë e

Elitat politike në Shqipëri dhe Maqedoni duhet të luftojë kundër vetes, kurse BE duhet të krijojë një institucion mbikëqyrës dhe vendimmarrës në vënien në funksion të sistemit gjyqësor në Maqedoni

arsyeshme që Maqedonia ka probleme themelore në funksionimin e shtetit dhe së drejtës kur ende shohim politikan të korruptuar, ndër ta edhe persona që dëgjonim në Bombat e Zaevit sa ishte në opozitë ndaj të cilëve tani heshtet dhe nuk procedohen raste në organet gjyqësore. Nuk mund ti hedhim aq lehtë hi syve të BE-së, nëse nuk ndërmarrim hapa serioz për të prangosur personat që lanë prapa Maqedoninë për shumë vite nge partitë që ishin në pushtet më herët", thotë

KAM MARR 800 LETRA ME KËRCËNIME, PLUMBA DHE KUTI ME GJAK

Më kanë dërguar plumba dhe kuti të mbushura me gjak dhe tokë të mbuluar me gjak dhe kërcënime ndaj meje dhe familjes sime, zbuloi ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, Nikos Koxias në intervistën për radion greke "Njuz247". Siç raportoi korrespondentja e MIA-s nga Athina, shefi i diplomacisë greke foli për rritjen e gjuhës së urrejtjes në Greqi, për çka thotë se duhet të ndërpritet. "Kam marr 800 letra me kërcënime për jetën time dhe të familjes sime. Kam marr kuti të mbushura me gjak dhe më thonë se do të ketë gjak në familjen time. Dhe kuti me tokë të mbuluar me gjak. Kam marr madhësi të ndryshme të plumbave. Ku është prokurori? Këtu nuk kemi vetëm shpifje, këtu kemi vepër penale që arrijnë deri në krim. Njëjtë sikur me tentimet, qeveria apo ministrat e qeverisë, të mos e kryejnë detyrën e tyre sipas përzgjedhjes së tyre siç parasheh Kushtetuta, por në bazë të shantazheve dhe kërcënimeve. Këto janë krime të rënda, sipas ligjeve greke, për të cilët nuk shoh se reagon dikush", tha Koxias.



Bashkim Selmani. Sipas tij pa një pastrim dhe shkëputje të personave qofshin politikan e funksionarë qeveritar apo gjyqtarë që përdhosën të drejtën dhe gjyqësinë, nuk do ketë respektim të drejtave të qytetarëve dhe drejtësi kolektive për të gjithë. Qeveria duhet të merr hapa serioz drejt një gjyqësori të pavarur dhe të pastruar nga elementë korruptiv dhe kriminal. "Duke marrë parasysh faktin se ne kemi politikanë demagog dhe të padëgjueshëm, BE duhet të krijojë një institucion mbikëqyrës dhe vendimmarrës në vënien në funksion të sistemit gjyqësor në Maqedoni. Nëse nuk do ketë ndërhyrje urgjente në Maqedoni gjyqësori akoma edhe në vijim do jetë i prangosur nga faktorët devijues", thotë Bashkim Selmani. Si tërësi morale dhe politike, shton ai, të gjithë duhet të kenë përgjegjësi, edhe qytetarët që siç thotë Bashkim Selmani, rrinë të strukur dhe të heshtur ndaj padrejtësive. "Kur të gjithë bëjnë sikur po punojnë dhe nuk veprojnë realisht dhe kur qytetarët nuk janë aktiv, atëherë padrejtësitë e ndryshme bëhen komoditet për keqbërësit", thotë Bashkim Selmani. Ai flet për më të keqen, prolongimin e negociatave për anëtarësim, nëse individët nuk marrin përgjegjësi, dhe Qeveria nuk tregohet e prerë për të reformuar gjyqësorin.

"Deri në qershor qytetarët dhe ndërkombëtarët duhet të krijojnë besim se vërtetë është punuar, dhe vërtetë e kemi përgatitur veten për në BE, ndryshe BE si e ngarkuar që është me probleme të brendshme, përsëri mund të jetë në situatë të njëjtë të prolongojë negociatat për anëtarësim", thotë Bashkim Selmani.

Rrugë të qartë drejt BE-së



Nga Federica MOGHERINI dhe Johannes HAHN

Marrëveshja historike mes Shkupit dhe Athinës na ka bërë neve, europianëve, krenarë. Ajo paraqet ndryshim strategjik për të dyja vendet dhe për tërë Europën. Dëshmoi se edhe çështjet më të ndjeshme dhe historikisht më të ngarkuara mund të zgjidhen kur ka guxim dhe vizion. Ne të dy ishim të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes në Liqenin e Prespës. Atë që e pamë atje na e ka forcuar edhe më shumë besimin në një kontinent të bashkuar dhe në paqe me perspektivë europiane për Ballkanin Perëndimor si shtytës i stabilitetit në rrethin tonë më të afërt.

Këtë javë, vendet anëtare të BE-së pozitivisht iu përgjigjën kësaj arritjeje dhe përcaktuan rrugë të qartë drejt hapjes së negociatave me Shkupin, në muajin qershor 2019, duke përcaktuar vizion të qartë për vitin që vjen dhe përtej. Menjëherë ia filluam punës për këtë kapitull të ri dhe të përbashkët me Komisionin Evropian dhe filluam përgatitjet për bisedimet qasëse. Me padurim presim të punojmë me ju, që edhe ju t'i bëni ballë kësaj sfide të re me të njëjtën vendosmëri që ju ka sjellur deri te sukseset e fundit.

Jo shumë larg, vendi ishte në një krizë të thellë politike. Por, ju ia keni arritur ta tejkaloni atë. Keni arritur përparim në reformat kyçe - jo për Brukselin, por për të mirën e qytetarëve tuaj. Keni arritur marrëveshje me Bullgarinë dhe Greqinë, duke përkrahur një dinamikë të re bashkëpunimi në Europën Juglindore dhe hapjen e deryve për investim, vendeve të punës dhe zhvillimit. Të gjithë këto hapa pozitive janë frymëzim për tërë rajonin.

Rruga përpara është e qartë. Ajo çon drejt anëtarësimit tuaj në Bashkimin Evropian. Për ta arritur këtë, të gjitha forcat politike e kanë përgjegjësinë të mbajnë dialog konstruktiv dhe të vazhdojnë t'i realizojnë aspiratat e qytetarëve, përfshirë këtu sidomos nëpërmjet reformave në fushën e sundimit të së drejtës, shërbimet e sigurisë, administratën publike si dhe ekonomi funksionale të tregut. Këto parime janë në zemrën e tregimit të suksesshëm evropian. Ato janë gjithashtu ajo çfarë qytetarët e vendit tuaj e kërkojnë, duan dhe e meritojnë. Kjo është rruga jonë e përbashkët: sa më shumë që Shkupi i plotëson nevojat e qytetarëve të vet, aq më shpejt do të përparojë drejt anëtarësimit të plotë në BE.

Nga ana jonë, Komisioni veçmë ka filluar punën e nevojshme përgatitore për tu përgatitur për muajin qershor të 2019, përfshirë edhe kornizën e ardhshme negociuese. Ne gjithashtu jemi të gatshëm t'ju përkrahim në zbatimin e mëtejshëm të reformave. Të gjithë kanë një rol në këtë proces historik. Uniteti, guximi, përgjegjësia dhe pragmatizmi nga të gjithë do të jenë thelbësore. Të gjitha grupet politike dhe partitë, autoritetet vendore dhe shoqëria qytetare duhet të marrin përsipër përgjegjësi për këtë proces dhe së bashku ta përgatisin terrenin për negociatën.

Puna që do bëhet në vitin që vjen është investim në integrimin tuaj evropian. Çdo hap ka rëndësi. Të ecurit në këtë rrugë jo vetëm që do t'ju mundësojë hapje të negociatave por edhe ta bëni atë në mënyrën më efikase. Atë moment kur do të hapen negociatat zyrtarisht, ju do jeni veçmë në vrap.

Dyert e Unionit janë të hapura. Rruga juaj drejt Bashkimit Evropian është bërë e pakthyeshme. Tani varet prej jush të ecni para në këtë rrugë drejt një ardhmërie me prosperitet të përbashkët dhe siguri.

Ky është vendim i lirë dhe sovran i popullit tuaj - i askujt tjetër. Ëndrra jonë për kontinent të bashkuar të Europës është në duart tuaja.

(Federica Mogherini është përfaqësuese e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe zëvendëskryetare e Komisionit Evropian. Johannes Hahn është Komisioner për Politikë Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerim. Nga mediat në gjuhën shqipe, gazeta KOHA ka të drejtën ekskluzive për botimin e këtij shkrimi)

Partitë nuk i arsyetojnë dot 110 mijë euro!

Shkup, 28 qershor - Gjithsej 3.676.000 denarë janë shpenzimet e pambuluara të të gjithë 11 partive politike të cilat kanë marrë pjesë në fushatën për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2016, ka treguar revizioni. Pjesa më e madhe e shpenzimeve, 75,32 për qind janë për reklamim të paguar politik. Siç tha në konferencën për shtyp Mijallçe Durgutov, revizor i angazhuar për informim në Entin Shtetëror për Revizion, të ardhurat e përgjithshme të partive në fushatë kanë qenë 228.912.000 denarë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme 235.588.000 denarë. Në pajtueshmëri të raportit të ESHR-së për vitin 2017 që e prezantoi Durgutov, janë revizuar 258.840.000 denarë të ardhura publike dhe 106.671.000 shpenzime publike. Në pjesën e furnizimeve publike janë konstatuar 63 konstatime të cilat u dedikohet parregullsi. Durgutov për hollësi rreth raportit udhëzoi në internet faqen e ESHR-së ku ai do të publikohet, për herë të parë, siç theksoi, në tre gjuhë - maqedonase, shqipe dhe angleze.

Nga sot nis ngrohja, javën e ardhshme deri në 35 gradë

Shkup, 28 qershor - Mot më i ngrohtë me periudha diellore, por edhe reshje të rrëmbyeshme lokale të shiut, bubullima dhe erë, paralajmëron prej sot Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike. Temperatura e mëngjesit do të lëvizë prej nëntë deri në 16, ndërsa ajo e ditës prej 15 deri në 28 gradë. UV-indeksi do të jetë 6. Në Shkup do të mbajë mot më i ngrohtë, me periudha diellore dhe me erë të dobët deri në mesatare veriperëndimore. Temperatura e mëngjesit do të zbrësë deri në 15, ndërsa ajo e ditës do të arrijë deri në 21 gradë. Edhe të shtunën moti do të jetë më i ngrohtë, paradite me periudha diellore, ndërsa pasdite me reshje të rrëmbyeshme lokale të shiut dhe bubullima. Nga e diela moti do të jetë me diell, kryesisht stabil dhe i ngrohtë, në disa ditë të javës së ardhshme edhe deri në 35 gradë Celsius.

HYSA NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË NATO-S NË SHKUP

PËRVEÇ NATO-S, ALEANCAT TJERA KËRCËNOJNË SIGURINË

“Në Kosovë, NATO është prezent përmes misionit të KFOR-it ku shërbejnë forca ushtarake nga 30 shtete (22 shtete anëtare dhe 8 partnere) dhe Kosova dëshiron ta përkthejë këtë realitet duke qenë vend misioni, në të qenurit pjesë e Aleancës veriatlantike. Me gjithë fqinjët kemi marrëdhënie të shkëlqyera përveç me Serbinë, me të cilën zhvillohet dialog në nivel presidentësh në Bruksel”, ka thënë Hysa



i pozicionit zyrtar nga Beogradi që ka pasur një narracion tejet agresiv duke bërë vlerësime të rënda jo vetëm për shqiptarët kudo që jetojnë, por edhe për Kroacinë, Bosnjën etj. Ambasadorja serbe ka thënë që Serbia ka pozicion dallues dhe se ajo do të mbajë marrëdhënie të mira me Rusinë e Kinën, si edhe me Amerikën.

Ambasadorja serbe, Tomoviç madje ka akuzuar shqiptarët se dëshirojnë të krijojnë Shqipërinë e Madhe, që sipas saj, është kërcënim për siguri dhe se Kosova e Shqipëria dëshirojnë të bëjnë përfaqësi të përbashkëta diplomatike! Ajo madje tha se e ashtuquajtura “Platforma e Tiranës” e partive sh-

qiptare në Maqedoni është dëshmi për kërcënimin. Ajo ka insistuar se pala kosovare nuk i përmbahet marrëveshjes së Brukselit dhe se Beogradi do të insistojë në negociatat që të kryhet marrëveshja për asociacionin e komunave. “Ne dëshirojmë që shtetet tjera ti qasen dialogut tonë me Kosovën si status neutral. Me Kroacinë kemi dallime që nga Lufta e Dytë Botërore”, ka thënë ambasadorja serbe, ndërsa ka theksuar që shteti i saj dëshiron marrëdhënie të mira edhe me Turqinë. Ambasadori i Kosovës në Maqedoni, Ylber Hysa, ndërkohë ka theksuar se Kosova është foshnja më e re e Europës që ka lindur përmes NATO-s dhe kjo e bënë atë të

shoh edhe fqinjësinë e mirë dhe rajonin stabil vetëm përmes të qenurit NATO.

“Në Kosovë, NATO është prezent përmes misionit të KFOR-it ku shërbejnë forca ushtarake nga 30 shtete (22 shtete anëtare dhe 8 partnere) dhe Kosova dëshiron ta përkthejë këtë realitet duke qenë vend misioni, në të qenurit pjesë e Aleancës veriatlantike. Me gjithë fqinjët kemi marrëdhënie të shkëlqyera përveç me Serbinë, me të cilën zhvillohet dialog në nivel presidentësh në Bruksel”, ka thënë Hysa. Kosova, ka vazhduar më tej ambasadori Hysa, i gëzohet negociatës së guximshme dhe të suksesshme në mes të Shkupit e Athinës që mund të bëjë fqin e saj anëtare të NATO-s. Kjo do të thotë që nga katër fqinjët e Kosovës, tashmë tre nga to do të jenë NATO, është shprehur Hysa.

“Në këtë botë që jetojmë me një vakum gjeopolitik dhe me sfida e interferime të faktorëve joperëndimorë në rajonin e Ballkanit me agjenda të ndryshme, ne mendojmë që vetëm NATO është garantuese e stabilitetit dhe prosperitetit. Për Kosovën, çfarëdo pranie tjetër e ndonjë aleance ushtarake në rajon, është kërcënuese”, ka thënë ambasadori Hysa pas panelistes - ambasadores serbe. Hysa ka thënë që për Kosovën nuk ka alternative tjetër për NATO-n.

ZAEV NË POLONI, TAKON MORAVJECKIN

Maqedonia t'i fillojë negociatat me BE-në

Varshavë, 28 qershor - Kryeministri Zoran Zaev kishte mëngjes pune me kryeministrin polak Mateus Moravjecki, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani dhe ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov. Pas mëngjesit të punës të delegacioneve qeveritare të të dy shteteve, kryeministrat Zaev dhe Moravjecki kishin deklaratë për mediat. Moravjecki, në konferencë të përbashkët shtypi me Zaevin pas mëngjesit të punës të të dy delegacioneve, u falënderua që me vizitën e Zaevit, për herë të parë pas 25 viteve nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve, realizohet takim i nivelit të kryeministrave.

Kryeministri polak shprehu mbështetje për integrimin euroatlantike të Maqedonisë. Ai uroi për marrëveshjen e arritur me Greqinë, që, siç tha, hap mundësi që të fillojnë bisedime për inkuadrim të

Maqedonisë në BE. Ai shtoi se Polonia e mbështet Maqedoninë edhe në integrimin në NATO, që, siç tha, do të jetë mirë edhe për sigurinë në këtë pjesë të Evropës. Zaev në deklaratë fillimisht, në emër të qytetarëve dhe të Qeverisë së RM-së, uroi 100-vjetorin nga kthimi i pavarësisë së Republikës së Polonisë, që vendi e shënon këtë vit. “Dua t'i falënderohem kryeministrit Moravjecki, Qeverisë së Polonisë dhe qytetarëve të Polonisë, për mbështetjen e çmueshme në integrimin euroatlantike të Republikës së Maqedonisë, në momentet kyçe kur kjo ishte e nevojshme për qytetarët e tanë”, tha Zaev.

Ai theksoi se mbështetja nga Polonia për negociatat për inkuadrim në BE dhe ftesë për anëtarësim në NATO, posaçërisht pas marrëveshjes historike që e arritëm me Greqinë, është shumë e rëndësishme për Maqedoninë, nëse merret parasysh se vjen në

momente para Samitit të Këshillit të BE-së, në të cilin vendi pret të konfirmohen lajmet pozitive për fillim të negociatave me BE-në. “Vendimi për hapje të negociatave inkuadruese të Maqedonisë me BE-në dhe ftesa nga Aleanca për hyrje të Maqedonisë në NATO, do të thotë siguri dhe stabilitet më të madh të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor, por edhe të Evropës dhe botës”, vlerësoi Zaev. Sipas tij, lajmet e mira për integrimin e hapura euroatlantike të Republikës së Maqedonisë, janë mesazh i fuqishëm edhe deri te vendet e rajonit, se politikat reformuese dhe përcaktimi drejt mbylljes së çështjeve bilaterale njihet dhe vlerësohet nga BE-ja dhe NATO-ja. “Me këtë, kemi edhe motiv të fuqishëm që të qëndrohet në rrugën e proceseve demokratike që vetëm çojnë drejt botës më të qetë dhe prosperuese”, tha kryeministri Zaev. Ai theksoi se “për Maqedoninë dhe

për rajonin, integrimet euroatlantike do të thonë edhe zhvillim ekonomik”.

“Me mundësinë e integritit të Republikës së Maqedonisë në NATO dhe BE, numri i investuesve të interesuar të huaj çdo ditë porritet, ndërsa është motivuar edhe ekonomia vendore që në mënyrë plotësuese të investohet, për çka si Qeveri japim mbështetje të fuqishme. Ai theksoi se i ka kumtuar kryeministrin Moravjecki se Qeveria e Republikës së Maqedonisë është orientuar drejt përmirësimit të klimës afariste dhe kushteve të punës, dhe mbështetje, në mënyrë të njëjtë për kompanitë vendore dhe të huaja. “Edhe në këtë drejtim duam ta thellojmë bashkëpunimin ekonomik me Poloninë, i cili, shikuar përmes rritjes së këmbimit tregtar, shënon lëvizje pozitive dhe jep shanse për suksese më të mëdha ekonomike”, tha kryeministri Zaev.

PËRFORCOHEN KAPACITETET NACIONALE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

KORRUPSIONI TË LUFTOHET ME "INFORMATORË"

Njëra prej pajisjeve më të forta të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, siç thuhet në raport, gjithsesi është mbështetja e "informatoreve". Megjithatë, Ligji për informatorë në Maqedoni edhe tre vite pas hyrjes në fuqi, deri më tani nuk i ka dhënë rezultatet e parashikuara



Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 28 qershor - Krimi i organizuar dhe korrupsioni paraqesin sferat më të shpeshta ku ndër vite - Bashkimi Evropian, përmes raporteve të ndryshme i jep vërejtjet dhe i udhëzon institucionet e Maqedonisë se si duhet të përmirësohen. Faktin se në organet shtetërore ekziston korrupsioni, nuk e mohan as ministri i Punë të Brendshme, Oliver Spasovski. Gjatë përmblyjes së projektit për përfundimin e kapaciteteve nacionale në luftë kundër krimit të organizuar, ai tha se edhe Qeveria është e vetëdijshme se edhe më tutje nevojiten reforma kundër luftës së krimit të organizuar, siç është rasti me krimin financiar dhe larjen e parave, përmirësimin e evidencës për hetime, aktakuza dhe aktgjykime.

"Ky projekt e ka arritur qëllimin e tij, me çka gjatë 18 muajve të kaluar, është rritur kapaciteti operativ i një sërë institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në kuadër të Komponentës së Dytë, të cilët për detyrë e kishte ta realizojë MPB, u përgatitën një varg dokumentesh dhe trajtimeve

sa i përket krimit të organizuar, hetimeve financiare dhe krimit kompjuterik. Strategjia dhe plani aksionar në luftën kundër krimit kompjuterik paraqet njërin prej tyre. Në periudhën që vijon, këto dokumente dhe rekomandime nga ana e jonë do të shqyrtohen me seriozitet, në bazë të të cilave edhe do të vepohet", tha Spasovski.

Njëra prej pajisjeve më të forta të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, siç thuhet në raportin e projektit "Përfundimi i kapaciteteve të nacional për luftën kundër korrupsionit", gjithsesi është mbështetja e "Informatoreve".

Megjithatë, Ligji për informatorë në Maqedoni pothuajse tre vite pas hyrjes në fuqi, edhe më tej nuk i jep rezultat e parashikuara. Zëvendësministri i Drejtësisë, Oliver Ristovski, duke folur për ecurinë e projektit, theksoi se është përgatitur një "Udhëzues për informatorë", përmes të cilit synohet promovimi i kulturës së përgjegjshme, integritetit dhe nxitjes së denoncimit të veprimeve të kundërligjshme.

"Ky projekt ishte tepër i rëndësishëm

në pjesën e përfundimit të kapaciteteve të organeve të jurisprudencës, në veçanti në zbatimin e Ligjit për shkatërrimin e krimit të organizuar. Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe ishin të fokusuara drejtë përfundimit të kapaciteteve të Prokurorisë Publike, Komisionit shtetëror për luftën kundër korrupsionit, Agjencisë për konfiskim të pronës dhe kështu me radhë. Duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e krimit financiar dhe veprave penale që lidhen me korrupsionin në nivel të lartë, një prej qëllimeve të këtij projekti ishte përfundimi i aftësive dhe zotësisë individuale të prokurorëve gjatë kohës së realizimit të hetimeve paraprake dhe menaxhimit e informacioneve që i posedojnë, respektivisht zbatimin e Ligjit për informator", tha Ristovski.

Policia Financiare, Drejtoria e Dogana dhe Komisioni për luftën kundër korrupsionit ishin po ashtu pjesë e këtyre trajnimeve, me çka qëllimi kryesor ishte rritja e kapaciteteve operative për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacioneve gjatë hetimeve të krimit financiar dhe menaxhimit me lëndët e kësaj sfere.

Nis gjykimi i Mijallkovit, Grujevski gjykohet në mungesë

Shkup, 28 qershor - Këshilli gjyqësor me të cilin kryeson gjykatësja Xheneta Bektoviq në seancën e djeshme gjyqësore për rastin "Arka" solli vendim që të akuzuarit Goran Grujevski t'i gjykohet në mungesë, duke pasur parasysh se Gjykata Supreme në Athinë ka sjellë vendim kundër ekstradimitit të akuzuarit dhe me të njëjtin është ndërprerë paraburgimi i tij dhe është lëshuar në liri. Në kontekst të kësaj Gjykata e merr parasysh edhe njoftimin nga SPB Shkup se Grujevski nuk është i kapshëm për organet e ndjekjes. Pas pauzës, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet për mbajtje të debatit kryesor, me ç'rast filloi gjykimi për këtë lëndë. Në bankën e të akuzuarve në Gjykatën Penale janë ish-drejtori i DSK, -së Sasho Mijallkov, ish-shëfi i kabinetit të tij Toni Jakimovski dhe ish ndihmës-ministri në MPB, Nebojsa Stajkoviq. Mbrojtësi i Grujevskit, Petar

Vasilev kërkoi vendim me shkrim për vendimin, me qëllim që të realizojë të drejtën e ankesës. Paraprakisht, pas ekspertizës së realizuar, Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme në Athinë ka sjellë vendim me të cilin pranohet ankesë formale dhe thelbësore të të akuzuarit dhe vendoset kundër ekstradimitit dhe t'i gjykohet në IRJM. "Me të njëjtin vendim ndërpritet paraburgimi i tij dhe ai lirohet nga burgu, nëse nuk mbahet për ndonjë arsye tjetër. Gjykata konstaton se tek arsye janë theksuar aktakuza për 'Target-Fortesa' dhe 'Arka', tha gjykatësja Bektoviq. Prokurori nga PSP, Artan Ajro tha se pas vendimit dhe prononcimit të avokatit Goran Grujevski se është qytetar i lirë, e tërheq propozimin për ndarje të procedurës dhe kërkoi që t'i gjykohet në mungesë. Avokati Vasilev, ndaj kësaj reagoi se propozimi është tejet i hershëm duke pasur parasysh se procedura e ekstradi-

mit nuk ka përfunduar tërësisht. "Vendimi nuk do të thotë edhe përfundim i procedurës për ekstradim. Ai përfundon me vendim të ministrit. Konsideroj se propozimi i këtillë është tejet i hershëm dhe kërkoi që Gjykata ta refuzojë", tha Vasilev. Prokurori publik nga PSP, Trajçe Pelivanov, lidhur me prononcimin e avokatit Vasilev, tha se duhet që kjo të refuzohet për shkak se Grujevski tanimë është qytet i lirë në Greqi dhe mund ta tërheqë kërkesën për azil dhe të ballafaqohet me aktakuza për të cilët ngarkohet në Maqedoni. Të akuzuarit në "Arka" ngarkohen për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimeve dhe shkaktim dëm Buxhetit në vlerë prej 862.045 euro për furnizimin e pajisjes elektronike-komunikuese për nevojat e Drejtorisë së pestë pranë DSK-së dhe trajnim për shfrytëzim të tyre nga një firmë nga Britania e Madhe.

KRONIKË

Djali therrë babanë me thikë

Një qytetar i Manastirit i moshës 50 vjeçare dje është therrë me thikë nga djali i tij 18-vjeçar gjatë një zënke familjare. Siç njoftoi MPB-ja, në orën 14:15 është raportuar se në Manastir në bulevardin "1 Maji" gjatë një zënke familjare K.Gj. me thikë ka therrë babain i tij A.Gj. në shpinë. A.Gj. është dërguar në Spitalin Klinik të Manastirit, por për shkak të lëndimeve serioze ai është dërguar në Klinikën Universitare "Nëna Tereza" në Shkup. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi inspektues nga Sektori për Punë të Brendshme Manastir, ndërsa janë ndërmarr masa për zbardhjen e plotë të rastit.

33-vjeçari sulmon policët në Gostivar

33 vjeçari me initiale D.K. nga Gostivari, të mërkurën rreth orës 12 e 50 minuta, në rrugën "Mara Ugrinova" në Gostivar, fillimisht ka dhënë razistencë aktive, kurse më pas edhe i ka sulmuar fizikisht dy pjesarët e policisë, të cilët kanë marrë masa dhe aktivitete që të njëjtin ta privojnë nga liria. Gjatë sulmit, D.K. ju ka shkakuar lëndime të dukshme, ku edhe është arrestuar dhe mbajtur për procedurë të mëturshme në Stacionin Policorë në Gostivar. Sipas policisë së Tetovës, i njëjti person pak kohë më parë në rrugën e "Ilindenit" në Gostivar, me armë zjarri, gjegjësisht pistoletë, nga ulësja e bashkëvoztësit të një veture, i është kërcënuar 45vjeçarit S.T. nga Gostivari se do ta vret atë. Bëhet e ditur se personi S.T. është i punësuar në Agjension për Sigurim, i cili ka lëvizur në këmbë në drejtim të sheshit të qytetit, dhe më pas me veturë menjëherë është larguar nga vendi. Punohet në zbardhjen e plotë të gjitha detajeve në veçanti lidhur me të dy rastet, nga të cilët rasti në dytë e ka paraqitur personi S.T. dhe pas dokumentimit të plot do të pasojnë edhe padi adekuate.

Aksidentohet 22-vjeçarja, vozitësi pa patentë shoferi

Në rrugën "Boge Veljanovski" në Gostivar, të mërkurën rreth orës 18 e 30 minuta, vetura e tipit "Ford Eskord" të cilën pa leje për vozitje e ka drejtuar 15 vjeçarja nga Gostivari, ka aksidentuar 22 vjeçarën F.M. këmbësore nga Gostivari. Nga ky aksident, këmbësorja nga Gostivari ka marrë lëndime trupore, ku me veturë tjetër është dërguar në Spitalin e përgjithshëm "Ferd Murat" në Gostivar, dhe pas dhënies së ndihmës mjeksore, e njëjta është lëshuar për shërim shtëpiak. Pas kryerjes së hetimeve, punohet në zbardhjen e të gjitha detajeve në veçanti lidhur me aksidentin në fjalë.

Aksident afër Orashës, dy të lënduar

Të mërkurën rreth orës 12 e 40 minuta, në rrugën lokale para hyrjes për në fshatin Orashë, ka ndodhur aksident trafiku, në të cilën pjesmarës kanë qenë dy vetura me targa të Tetovës, edhe atë, vetura e tipit "Ford Transit" e drejtuar nga 59 vjeçarja Z.M nga fshati Stara Sellë dhe vetura e tipit "Nissan" e drejtuar nga 55-vjeçarja M.H. nga fshati Orashë. Në këtë aksident, drejtuesi i veturës "Nissan" ka marrë lëndime të rënda trupore, ku pas dhënies së ndihmës mjeksore në Spitalin klinik të Tetovës, është lëshuar në shërim shtëpiak. Lëndime trupore ka marrë edhe drejtuesi i veturës "Ford Transit", i cili është ndaluar për shërim në Spitalin klinik të Tetovës, derisa dy udhëtarët nga e njëjta veturë kanë përfunduar me lëndime më të lehta trupore. Pas kryerjes së hetimeve, punohet në zbardhjen e shkaqeve, rrethanave, si dhe detajeve tjera lidhur me këtë aksident. (U.H)

NGA VITI SHKOLLOR 2007/2008 DERI 2017/2018

SHKOLLAT ME 30 MIJË NXËNËS MË PAK

Rënia prej rreth 30 mijë nxënës në periudhën e viteve 2007-2017, nga njëra anë dhe në anën tjetër rritje për rreth 3 mijë mësimdhënës në të njëjtin hark kohor, ka përmirësuar performancën e raporteve mësimdhënës/nxënës në nivel shteti. Mirëpo, pavarësisht kësaj, në shumë komuna kanë mbetur të hapura problemet me mbingarkesën e shkollave me paralele dhe numër të lartë nxënësish në klasë, sikurse është rasti me shkollat e Çairit



numër ishte 222.359 nxënës. Pra në kuotat fikse, në harkun kohor prej dhjetë viteve ka një rënie prej 29.911 nxënës. Por në të njëjtën kohë është shënuar rritje në numrin e mësimdhënësve të angazhuar në arsimin fillor edhe atë për 2961 më shumë për të njëjtën periudhë kohore. Nga gjithsej 15.330 arsimtarë në vitin 2007/2008, pas një dekade numri i tyre është rritur në 18.291 duke përmirësuar në këtë mënyrë performancën e raporteve mësimdhënës/nxënës.

Nëse para një dekade një mësuesi, respektivisht një arsimtari i takonte të ketë mesatarisht më

shumë se 14 nxënës, vitin e kaluar ky numër u zvogëluar për katër nxënës më pak. Pra ai raport ishte më tepër se 10 nxënës për një mësues/arsimtarë. Angazhimi i më tepër mësuesve dhe arsimtarëve nëpër shkollat fillore në një kohë kur kemi rënie konstante të numrit të nxënësve ka bërë që në rrafshin nacional të ketë ngarkesa më të vogla. Por, pavarësisht kësaj, kanë mbetur të hapura shumë problemet që kanë të bëjnë me shkollat e mbingarkuara me numër të madh paralelesh dhe me shumë nxënës në klasë. Kështu për shembull në shkollat fillore të Çairit dhe Butelit ende ka raste kur paralelet

e klasave të para formohen me nga 37 e 40 nxënës në klasë. Arsyeja ka të bëjë me mos financimin e paraleleve të reja nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, respektivisht Ministria e Financave. Këta të fundit arsyetohen me Ligjin ende në fuqi të ngrirjes së vendeve të reja të punës, ndërsa në MASH me mosdhënien e lejeve për vende të reja pune nga ana e MF-së. Ndërkaq, shkollat, të cilat edhe ashtu nuk kanë kompetenca për çështje të këtilla e kanë lënë zgjidhjen e problemit në dorë të komunave. Prej vitesh në Komunën e Çairit një pjesë e problemit me kuadrin mësimor është amortizuar duke i an-

gazhuar mësuesit në shkolla të caktuara dhe duke i paguar të njëjtit si të ishin ët punësuar në Komunë. Ky është rasti i dy mësimdhënësve në Shkollën Fillore "Ismail Qemali" të cilët punojnë mësues ndërsa paguhen nga Komuna. Nga sektori për çështje arsimore në këtë komunë, thonë se do ti përsërisin sërish kërkesat për vende të reja punë në shkollat fillore dhe shpresojnë se do të gjejnë mbështetje nga MASH, pra se kjo e fundit do të arrijë të bindë MF për nevojën e financimit të paraleleve të reja në shkollat ku do të ketë nevojë për diçka të këtillë.

Çairi është ndër komunat e pakta në Maqedoni e cila shëno rritje të numrit të nxënësve në shkollat fillore edhe përkundër rënies së përgjithshme. Vetëm për pesë muaj, nga shtatori i 2017 deri në shkurt të 2018, pra në gjysmë vjetorin e dytë të vitit shkollor 2017/2018 numri i nxënësve ishte ritur për 25. Ky numër pritet të rritet ende më shumë në muajin shtator, pasi rritjet janë shumë herë më të mëdha në fillim të vitit shkollor. Në shtator të 2017-ës, në shkollat fillore të Komunës së Çairit u regjistruan rreth 500 nxënës më shumë se sa ishin regjistruar në shtator të 2016-ës, ndërsa përderisa viti shkollor 2017/2018 ishte në rrjedhë e sipër shkollave të Çairit iu shtuan edhe 25 nxënës të tjerë.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 28 qershor - Për një dekadë Maqedonia ka humbur rreth 30 mijë nxënës në shkollat fillore. Kështu thonë të paktën të dhënat statistikore për numrin e nxënësve nga viti 2017/2008 deri në vitin 2017/2028. Sipas Entit Shtetëror të Statistikave vitin e kaluar shkollor (2017/2018) në 986 shkollat fillore kishte 192.448 nxënës për dallim prej vitit shkollor 2017/2008 kur ai

Bekteshi në Dibër

Dibër, 28 qershor - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, dje qëndroi për vizitë në Dibër, ku realizoi takim me kryetarin e komunës Ruzhdi Lata, ndërsa i vizitoi koll qendrën "Spajs" dhe "Banjat e Dibrës Capa". Në takim është bërë fjalë për investimet e deritanishme të realizuara në komunë, mundësitë që i ofron Dibra, si dhe volitshmëritë e Qeverisë për tërheqje të investimeve. Bekteshi dhe Lata e vizituan koll-qendrën "Sllajs", kompani e hapur me investim të një dibrani në SHBA, përmes së cilës dhjetë mijë piceri në 2000 qytete të SHBA-së i marrin porositi. Lata theksoi se Dibra është qyteti më i sigurt, ku nuk janë vërejtur kurrfarë dukurish negative, që sipas tij, është garanci më tepër që të investohet këtu. Ministri Bekteshi shprehu kënaqësi të madhe që është mysafir në Dibër dhe në kompaninë "Sllajs", e cila përveç në Dibër, është e locuar edhe në Ohër, duke theksuar si shembull jo vetëm për Dibrën, por edhe për tërë Maqedoninë. Bekteshi i vizitoi edhe "Banjat e Dibrës - Capa", e cila është shembull pozitiv i investimeve të suksesshme vendore.

"ROS ROTH" VAZHDON PUNIMET NË PARLAMENT

Sot presim paralajmërim zyrtar për ftesë në NATO

Shkup, 28 qershor - Punimet e seminarit të organizuar nga Kuvendi parlamentar i NATO-s për integrimet euroatlantike të Ballkanit Perëndimor kanë vijuar në Parlament. Koordinator nacional për NATO, Stevo Pendarovski, në fjalën e tij ka vënë në dukje se ftesa e anëtarësimit të vendit është një prej momenteve që qytetarët e vendit e presin me vite dhe faktori më i madh koheziv në vend, duke pasur parasysh se 80 për qind e qytetarëve janë pro anëtarësimit. Data e anëtarësimit është më e afërt pasi sipas tij gjatë vitit të kaluar Maqedonia mbylli tre çështje strategjike të rëndësishme - marrëveshjen për fqinjësi të mirë me Bullgarinë, në planin e brendshëm miratimin e Ligjit të gjuhëve, si element i rëndësishëm për plotësimin e marrëveshjes së Ohrit dhe e fundit është marrëveshja me Greqinë për zgjidhjen e çështjes së emrit. Të premtën pritet nga Brukseli njoftimi zyrtar se vendit do t'i jepet ftesa zyrtare në Samitin e ardhshëm të Aleancës në Bruksel, që zhvillohet më 11 dhe 12 korrik. Sipas tij nëse BE është e lodhur nga zgjerimi në NATO askujt nuk i shkon në mendje për Bregzit, madje as Islanda që nuk ushtri. "Kjo do të jetë një etapë e përfunduar nga asociimi ynë në Aleancë, duke pasur parasysh se Maqedonia mban rekord të paladishëm me 19 rrethe nga plani aksional për anëtarësim në NATO...Hera e parë ishte në vi-



tin 2001 kur kishim konflikt të brendshëm, kurse katër vite më vonë në vitin 2005 fituam statusin kandidat për në BE... Tani, një vit pas hyrjes së dhunshme në Parlament flasim se si Maqedonia do të bëhet anëtare e plotë e NATO-s dhe me datë për fillim të bisedimeve me BE-në në qershor të vitit të ardhshëm", ka thënë ndër të tjera Pendarovski. Duke iu referuar përfitimeve që ka vendi nga anëtarësimi në Nato Pendarovski vëren se edhe pse

integriteti territorial nuk është i rrezikuar, prapëseprapë bota përballet me luftëra hibride, sulme kibernetike, lajme të fabrikuara, të cilat dëmtojnë ekonominë e vendit. Sessionet e ditës së dytë të seminarit i kushtohen vendeve aspirante të Ballkanit perëndimor me temë "Rruga përpara, reformat në sektorët e mbrojtjes dhe sigurisë", si edhe "Nga Shkupi në Bruksel, hapat drejt procesit integruar". (E.H)

RRITET NDIHMA PËR BUJQIT DHE INDUSTRIJË PËRPUNUESE

Merrijeten e subvencioneve për domatet dhe pemët e grumbulluara, si dhe me blerjen e 12 mijë tonë të grurit për rezervat shtetërore, Ministria e Bujqësisë është e bindur se dukshëm do të zbuten problemet me shitblerjen dhe çmimet e ulëta të pemë-perimeve në shtet. Njëkohësisht, po punohet edhe në hapjen e qendrave grumbulluese dhe distributive

SUBVENCIONE MË TË LARTA PËR DOMATET DHE PEMËT



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 qershor - Ministria e Bujqësisë me rritjen e subvencioneve për domatet dhe pemët e grumbulluara, si dhe me blerjen e 12 mijë tonë të grurit për rezervat shtetërore, pritet të zbusë dukshëm problemet me shitblerjen dhe çmimet e ulëta të pemë-perimeve në shtet.

Njëherësh, po ndërmerren edhe aktivitete për rritjen e plasmanit të prodhimeve bujqësore nga Maqedonia jashtë shtetit, si dhe për hapjen e qendrave grumbulluese dhe distributive. Me vendimet e fundit qeveritare, prej sivjet rriten subvencionet për pemët e dorëzuara në industrinë përpunuese prej dy në tre denarë. Rriten edhe subvencionet prej tre në shtatë denarë për kilogram domatesh të dorëzuara në kapacitetet prodhuese.

Subvencionet pritet të ndihmojnë prodhuesit jo vetëm të pleshkave në Rosoman, ku në 5000 hektarë pritet të grumbullohen deri në 13 mijë tonë pjeshka. Së fundmi,

çmimi grumbullues i këtyre pemëve ishte prej 20 deri 23 denarë.

Kohë më parë, ministri i Bujqësisë, Ljupčo Nikolovski, theksoi se Qeveria përmes Ministrisë së Bujqësisë angazhohet në mënyrë intensive për të gjetur tregje të reja, jo vetëm për pjeshkat, por edhe për prodhimet e tjera bujqësore. Në këtë drejtim vazhdojnë edhe aktivitetet për rritjen e eksportit të prodhimeve bujqësore në Federatën Ruse si treg tradicional i prodhuesve nga Maqedonia.

Ekipe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Odës Maqedonase-Ruse kanë mbajtur disa takime me përfaqësues të përgjegjësve të "Rosejhosnador", me qëllim të eliminimit të

ZBRITJE MINIMALE E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Komisioni Rregullator për Energjetikë informon se do të ketë zbritje minimale të çmimit të energjisë elektrike. Seanca përgatitore për çmimin e energjisë elektrike është

planifikuar për sot (e premte), ku është paralajmëruar konferencë për shtyp e përfaqësuesve të KRRE-së, ku do të publikojnë zbritjen e çmimit të energjisë elektrike.

të gjitha barrierave potenciale dhe rritjes së eksportit. Gjithashtu, punohet në projekt të ri, përmes së cilit afaristët nga Maqedonia do të realizojnë shitje të drejtpërdrejtë në zinxhirët rusë të marketeve. Kjo pritet të realizohet përmes shtëpisë së Maqedonisë në Rusi, duke evituar ndërmjetësit që për momentin

i diktojnë dhe kushtëzojnë çmimet dhe sasinë e prodhuesve, gjithnjë në dëm të fermerëve. Njëherazi në takimin e fundit të Komitetit qeveritar për bujqësi është konstatuar se problemi më i madh për momentin është mungesa e bazës përkatëse të të dhënave për sasinë, çmimet dhe dinamikës e sezonit në kohën e

vjeljes së prodhimeve, me qëllim që ato të ofrohen në tregjet e jashtme.

Ministri i Bujqësisë, Nikolovski, ka bërë të ditur se para disa muajsh është dërguar shkresë deri tek të gjithë përfaqësitë diplomatike të Maqedonisë, që të ndihmojnë në hapjen e tregjeve të reja për prodhimet bujqësore nga Maqedonia. Sipas tij, edhe dikasteri i bujqësisë ka përgatitur listën e 50 kompanive të interesuara për investime, ndërsa një pjesë e tyre janë të interesuara edhe për ndërtimin e qendrave grumbulluese-distributive. Në këtë drejtim, Ministria e Bujqësisë ka përgatitur edhe hartën e rajoneve ku mund të ndërtohen ato.

Në ndërkohë, Qeveria si masë intervenuese për të zbutur problemin me grumbullimin e domateve vendosi që me shtatë denarë të ndihmohen fermerët që do të dorëzojnë këto perime tek kapacitetet prodhuese, apo tek grumbulluesit e regjistruar. Masa do të vlejë deri më 15 korrik, deri kur pritet të grumbullohen 500 tonë domate. Për pagesën e subvencioneve të rritura prej tre në shtatë denarë janë ndarë dy milionë denarë. Ministria e Bujqësisë ka ndërmarrë një hap të tillë për të balancuar ofertën dhe kërkesën në treg si dhe çmimin e ulët grumbullues. Kjo masë intervenuese pritet të stabilizojë tregun e domateve, ndërsa teprica e prodhimit pritet të përfundojë si lëndë e parë në industrinë përpunuese.

Nga ana tjetër, Agjencia e rezervave shtetërore pritet të blejë 12 mijë tonë grurë nga prodhuesit vendor. Kjo do të motivojë mullisët të blejnë grurë vendor që do t'ia shesin agjencisë, ndërsa blerja intervenuese do të ndihmojë të arrihet çmim solid grumbullues i grurit vendor që sivjet të ketë rendimente prej afër 300 mijë tonë.

SHPALLET THIRRJA PËR MBËSHTETJE TË AVIKOMPANIVE TË SUBVENCIONUARA

Në gusht nisin fluturimet e lira

Shkup, 28 qershor - Nga sot e deri më 27 korrik të vitit 2018 të gjithë kompanitë ajrore të huaja dhe vendore do të mund të konkurrojnë në thirrjen publike për zgjedhjen e kompanisë me buxhet të ulët, të cilat më përkrahjen financiare nga shteti - do të vendosin destinacione të reja nga aeroportet e Maqedonisë dhe atë së paku dy destinacione të reja nga aeroporti ndërkombëtar i Shkupit dhe katër destinacione të reja nga aeroporti i Ohrit.

"Marrëveshja duhet të nënshkruhet në gusht të këtij viti me kompaninë ajrore, që do të zgjidhet në thirrjen që për këtë dedikim e ka publikuar sot Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Të gjitha kompanitë e huaja dhe vendore dokumentacionin tenderik më ofertat e tyre që do të ofrojnë çmim më të volitshëm mund ti parashtrajnë deri më datën 27 të muajit të ardhshëm, ku dhe do të bëhet hapja publike e ofertave. Përparësi në



zgjidhjen do të ketë kompania ajrore, e cila do të ketë ofertë me çmim më të lirë të biletave, si dhe do të rrisë më shumë destinacione të fluturimeve dhe gjatë tre viteve të ardhshme do të marrë përkrahje financiare prej 5 milionë euro", tha Goran Sugarevski, ministër i Transportit dhe Lidhjeve.

Për çdo destinacion të ri nga aeroportet në Shkup dhe Ohër, Sugarevski tha do të paguhet kompensim i njëfishtë prej 40.000 eurove. Për çdo udhëtar në tre vitet e ardh-

shme për destinacione nga Aeroporti i Shkupit, aviokompania do të fitojë nga nëntë, respektivisht tetë dhe shtatë euro, ndërsa nga Aeroporti i Ohrit përkrahja financiare për një udhëtar për vitin e parë do të jetë 13 euro, respektivisht 12 dhe 11 euro për vitin e dytë dhe të tretë. Kompanitë që do të aplikojnë, mes tjerash duhet të kenë transportuar të paktën 10 milionë udhëtarë dhe të kanë realizuar fitim prej 25 milionë euro vitin e kaluar. Ministria ka sqaruar edhe procedurën nëse

në tender paraqiten dy ose tre kompani me ofertë të njëjtë. Në bazë të thirrjes publike, tha Sugarevski, pavarësisht nëse do të ketë më shumë oferta të njëjta, do të përzgjidhet vetëm njëra kompani ajrore.

"Kompanitë që do të aplikojnë, mes tjerash duhet të kenë transportuar të paktën 10 milionë udhëtarë dhe të kanë realizuar fitim prej 25 milionë euro vitin e kaluar. Përkrahja financiare do t'i ndahet kompanisë ajrore, e cila do të ofrojë numër më të madh të destinacioneve, në të cilat do të operojë nga dhe deri te aeroporti ndërkombëtar Shkup dhe aeroporti i Ohrit, të cilët nuk janë shërbyer me transport të rregullt ajror në dy sezonet e kaluara", tha Sugarevski.

Sipas tij, tërë procedura do të zhvillohet në mënyrë publike dhe transparente, ndërsa qëllimi kryesor është rritja e komunikacionit ajror dhe sigurimi i destinacioneve

atraktive për qytetarët në pajtim me nevojat e tyre me çmime të lira të biletave. Në thirrje mund të paraqiten të gjitha kompanitë ajrore nga vendi dhe të huaja, duke e përfshirë edhe aviokompaninë me buxhet të ulët "Viz Air", e cila gjatë gjashtë viteve të kaluara, me dy marrëveshje të firmosura me shtetin, fitoi 9.5 milionë euro subvencione. Sugarevski para gazetarëve ka thënë gjithashtu se me mjetet që subvencionon kompanitë ajrore, nuk mund të hap aviokompani kombëtare, pasi siç është shprehur ai, mjetet nuk jua në të mjaftueshme. "Shteti nuk jep ndihma financiare për kompanitë e huaja, por i subvencionon. Kompania ajrore që do të zgjidhet pas muajit gusht, gjatë tre viteve të ardhshme do të subvencionohet me 5 milionë euro, ndërsa për këtë vit janë siguruar rreth 850 mijë euro. Për vitin 2019 dhe 2020 janë planifikuar 104.2 milionë euro apo rreth 1.7 milionë euro, ndërsa për vitin 2021 do të ndahen 900 mijë euro", tha Sugarevski.

(Z.V)

Këshilli organizativ ka njoftuar se shumë shpejt do të dalë me pres konferencë për media ku edhe do të shpalos dokumentet, kurse nënvizuan se janë paraparë edhe protesta të reja. Nga institucionet tjera ende nuk kanë dalur me qëndrim për takimet e mbrëmshme dhe për hapat që do të ndërmerren në të ardhmen

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 28 qershor - Drejtues të Lëvizjes Anti-Bixhoz të mërkurën mbrëma kanë realizuar takim në Selinë e Bashkimit Demokratik për Integrim me kryetarin e kësaj partie, Ali Ahmeti dhe nënkryetarët, për të shprehur revoltën e tyre ndaj punëve të rifilluara për hapjen e kazinosë në rrugën "176" në Reçicë të Vogël. Para këtij takimi, po ashtu është realizuar edhe një takim me kryetaren e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, ku është marrë garanca se nuk do të lejohet hapja e kazinosë.

"Kishim takime intensive duke filluar njëherë prej kryetares së Komunës, Teuta Arifi, me të cilën kishim një takim në Komunën e Tetovës, gjithashtu realizuam takim edhe me kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti, ku ishin edhe dy nënkryetarët e partisë Nevzat Bejta dhe Izet Mexhiti. Është premtuar dhe është garantuar nga të gjithë se ajo kazi-

PUNOHET NË HAPJEN E KAZINOSË, BANORËT REAGOJNË

VAZHDOJNË TENTIMET PËR NDALIMIN E KAZINOSË



no nuk mund të hapet pasi nuk ka kurrfarë dokumenti. I gjithë ai provokim që bëhet me punët që zhvillohen atje - është në të zezë dhe në mënyrë ilegale, ndërsa tani presim që organet kompetente të veprojnë", deklaroi Jushi Emërlahu nga Lëvizja Anti-Bixhoz.

Ai ka njoftuar se do të realizohet takim në mes të organeve kompetente për të ndaluar hapjen e kësaj kazinoje. "Neve na tangon ajo që në

atë objekt po zhvillohen punime në drejtim të hapjes së kazinosë dhe kemi marrë garanca se prej sot do të ketë takim në mes të komunës dhe Qeverisë, ndërsa do të marrin pjesë edhe policia. Pas takimit do të dalin me deklaratë, është mirë që ju të drejtoheni edhe te Komuna e Tetovës, sepse ai objekt nuk posedon asnjë leje pune dhe për këtë - kazinoja në atë objekt nuk do të hapet dhe tash se si do të rrjedhin punët

me shtetin, apo se çfarë masa do të ndërmarrë shteti, do të shohim në vazhdim", tha ai. Këshilli organizativ ka njoftuar se shumë shpejt do të dalë me pres konferencë për media ku edhe do të shpalos dokumentet, kurse nënvizuan se janë paraparë edhe protesta të reja.

"Nëse ata vazhdojnë të punojnë, ne kemi paraparë edhe organizimin e protestave. Kur organizuam protestën e parë, patëm

theksuar se kjo për ne nuk është mbarimi, por ky është vetëm fillimi i protestave dhe me protesta do të vazhdojmë derisa të silllet një Ligj që ne përfundimisht të lirohemi prej kësaj të zeze", deklaroi Emërlahu. Nga institucionet tjera ende nuk kanë dalë me qëndrim për takimet e mbrëmshme dhe për hapat që do të ndërmerren në të ardhmen. Në një postim të Lëvizjes Antii-bixhoz, thonë se kanë marrë premtime nga deputetët se kazinoja nuk do të hapet. "Edhe përkundër vendimit të Gjykatës Administrative për të ndaluar punën në këtë objekt, edhe përkundër premtimeve të Komunës së Tetovës që ky objekt nuk do të hapet si kazino, puna e tyre për ta hapur vazhdon me intensitet të plotë. Këshilli i Lëvizjes Anti Bixhoz ka marrë premtime nga gjitha grupet parlamentare dhe nga kryetarja e Komunës së Tetovës se do angazhohen jo vetëm që kjo kazino nuk do hapet, por edhe se do mbështeten amendamentet e iniciativës për dislokimin e të gjitha kazinovave nga vendbanimet. Kush i gënjen qytetarët? Kush leverdis nga ky pisllek? Edhe policia e pafuqishme ndaj klaneve mafioze?", pyesin nga kjo Lëvizje.

Memorandum për mirëkuptim i televizioneve publike

Tiranë, 28 qershor - Drejtoret e serviseve publike të gjashtë vendeve nga Ballkani Perëndimor - Maqedonia, Shqipëria, BeH, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia, nënshkruan sot në Tiranë Memorandum për mirëkuptim, me çka hapet rruga për bashkëpunimin e tyre në kuadër të projektit të BE-së me vlerë prej 1,5 milionë euro. Projekti për mbështetje teknike të shërbimeve publike në Ballkanin Perëndimor (RTSH, BHRT, RTK, MRT, RTCC, RTS), do të zgjatë dy vjet, ndërsa do të ketë për qëllim të lehtësojë transformimin e shërbimeve publike nga mediat shtetërore në shërbime reale për qytetarët - që paraqet një nga prioritetet e BE-së për Ballkanin Perëndimor, njoftoi Delegacioni i BE-së në Shkup. Projekti ka tre qëllime kryesore - promovimin e standardeve evropiane dhe praktika-ve në Ballkanin Perëndimor për

media të pavarura dhe profesionale, strategji afatgjate për reforma në media, si dhe mbështetje në gazetarin hulumtues dhe shkëmbim rajonal të materialeve të digjitalizuara të arkivuara. Gjatë konferencës në Tiranë, ku u nënshkrua Memorandumi, pjesëmarrës ishin 60 përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësuesit e menaxhimit të shërbimeve publike, si dhe nga trupat rregullator për media nga Maqedonia, Shqipëria, BeH, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Projekti miratohet nga Federata ndërkombëtare e gazetarëve (FNG) së bashku me Bashkimin për radiodifuzion evropian (BRE), Federata evropiane e gazetarëve (FEG), Transmetuesi publik austriak (TPA), Rrjeti ballkanik për gazetarit hulumtues (BIRN) dhe Zyra e shkëmbimit evropian të lajmeve për Evropën Juglindore.

ASH akuza për gjendjen e rrugëve në Tetovë

Tetovë, 28 qershor - Aleanca për Shqiptarët - Dega në Tetovë ka drejtuar akuza ndaj Komunës së Tetovës për infrastrukturën rrugore, gropat në qytet, rrethinë dhe në Malësinë e Tetovës. Nga kjo parti dje para Komunës së Tetovës janë ekspozuar fotografi me gropat dhe me rrugë të dëmtuara. Sipas kryetarit të Degës së Tetovës të Aleancës për Shqiptarët, Altrim Mamuti, para komunës është hapur ekspozita me 240 fotografi dhe me më shumë se 3000 gropat dhe kjo është vetëm një përqindje e vogël nga gjendja reale në qytet.

"Gjendja e infrastrukturës së rrugëve në Tetovë është alarmante. Këto gropat janë në çdo lagje dhe në çdo vendbanim të Tetovës. Qytetarët paguajnë rregullisht mirëmbajtjen e rrugëve nëpërmjet sigurimit të automjeteve të tyre. Ndërkohë që paguajnë dhjetëfish më shumë për rregullimin e automjeteve që i amortizojnë gjatë vozitjeve nëpër rrugët e shkatërruara të Tetovës. Tendenca e shoferëve për ti evituar gropat shkaktuar



ton aksidente të shumta në komunikacion. Sot nga këtu pyesim kryetaren e Komunës se për çfarë arsye nuk i mirëmban rrugët e Tetovës me rrethinë? Për të shkaktuar dëme materiale dhe ekonomike qytetarit? Për t'ua vështirësuar komunikacionin? Apo për qëllime tjera më të ulëta", deklaroi Mamuti.

Nga Komuna e Tetovës janë përgjigjur se qytetarët e kanë dhënë verdiktin në zgjedhjet e fundit. "Ashtu sikurse të gjitha institucionet në Maqedoni duhet ta kryejnë punën e tyre, edhe gastro-nomia duhet ta kryej punën e vet.

Megjithatë, zgjedhjet përfunduan, rezultati ishte ai që ishte dhe normalisht partitë politike janë të lira të bëjnë aktivitetet e tyre. U ndër-tua koalicioni i turpit, bashkë me VMRO-në, dhe rezultati ishte ai që ishte. 5000 vota diferencë në favor të Teuta Arifit. Prandaj, çdo komentim më tej se ky verdikt, nuk ia vlen", tha Armend Fazliu, zëdhënës i Komunës së Tetovës. Dega e ASH-së në Tetovë ka bërë të ditur se ka fotografuar gjendjen e të gjitha rrugëve duke filluar nga Malësia, Reçica, Tetova, Drenovci dhe rrugë tjera. (U.H.)

Të qenurit në media dhe pranë saj, produktet mediatike mbase më tërheqin por dhe analiza mbi to mund të mos jetë tipike. Dhe dua të flas sot për tre produkte dhe fenomene që i shoh në media e që në të gjitha rastet edhe pse s'kanë asgjë me njëra-tjetrën i lidh fuqishëm sensi i përkatësisë ndonëse për arsye të ndryshme por që përshkruan shumë natyrën njerëzore, qoftë të autorëve qoftë të protagonistëve, por që ne na bën të kuptojmë veten dhe të tjerët më mirë.

BEYONCE DHE JAY Z

Prej ditësh ka dalë në qarkullim kënga e re e një prej çifteve më me influencë në muzikën botërore, Beyonce dhe Jay Z ose siç njihen së bashku The Carters. Kënga e tyre "Ape**t" për veç se është xhiruar në një prej muzeve më të njohur në botë, në Luvër në Paris, gjë që nuk bën vaki shpesh, ose thuajse asnjëherë. Gjithashtu shfaq vepra të njohura të artit botëror, por të vëna në një kontekst të fuqishëm politik, racor dhe personal.

Praktikisht video, por edhe teksti i këngës ka mesazhe të fuqishme që tenton të vë në fokus çështjet e barazisë raciale, vlerësimin personal të artistëve si simbol të respektit global ndaj të zinjve por edhe referime direkte me përplajtjet raciale të përditshmërisë aktuale politike amerikane.

Video ka më shumë detaje me mesazhe përtej artistike. Të parën që do theksoja është kur çifti por edhe vetë Beyonce këndon e kërcen para perëndeshës Nike, perëndeshës së fitores sipas mitologjisë greke. Çifti Carters por dhe vetë Beyonce duan të thonë se janë fitimtarë, se kanë fituar pas aq shumë dhimbjesh kolektive e personale, por edhe se ajo vetë është perëndeshë.

Skena tjera të videos lidhen me momentin kur Napoleoni shpallet mbret. Piktura impozante është me përmasa të mëdha dhe çifti përpiqet të tregojë madhësinë e tyre, por dhe racës së tyre në kontekst historik. Apo dhe momenti kur dy artistët qëndrojnë para Mona Lizës së famshme, në fillim dhe në fund të videos, por dhe me detajin ku para pikturës së famshme, një vajzë ia kreh flokët kaçurrelë një djali, që të dy me ngjyrë. Të gjitha skenat tentojnë të thonë se edhe e "zeza" është art se edhe e "zeza" mund të konsiderohet art i sofistikuar, tashmë. Teksti ka dhe reagime si personale ashtu dhe të përditshmërisë politike amerikane, por ajo që video dhe kënga bën, për mua, është një shprehje e fuqishme e gjithë asaj ngarkese sociale që çifti i njohur muzikor ka personalisht por dhe si pjesë e shoqërisë nga ku vjen, e që është

Beyonce, shqiponja dhe birra!



zezakët e Amerikës.

Suksesi i Beyonce dhe Jay Z është aq i madh sa edhe pasuria e tyre mund të numërohet me miliarda dollarë (besoj), por asgjë s'ka arritur të shpëtojë origjinën e tyre dhe të njerëzve të tyre. Shqetësimet dhe vuajtjet historike dhe në të tashmen, dëshirën e madhe të tregojnë me forcë dhe me agresivitet, racën, kush janë por mbi të gjitha dhe krenarinë për ata çka janë dhe çfarë kanë arritur shndërrorohet në mision.

E fuqishme është kjo ndjenjë. Dikush mund ta marrë gjithë këtë video si një arrogancë apo dhe kompleks, por gjithashtu është nevojë, që vjen e rrjedh natyrshëm

në venat e tyre për të treguar krenarinë. Një ndjenjë aq njerëzore, si të gjithë ne, si të gjithë pa dallim race, etnie e feje. Sepse të fuqishme janë këto rrënjët tona të cilat për një arsye ose tjetër i respektojmë dhe i duam.

XHAKA E SHAQIRI

Jo me një sofistikim arti, por me një sofistikim super sportiv, të njëjtën ndjesi dhe kënaqësi përjetuan ata, por dhe gjithë të tjerët që i ndjenë, kur Xhaka dhe Shaqiri dhanë golat.

E dimë gjithë historinë dhe historinë e krijuar se si djemtë shqiptar të kombëtares zvicerane reagon kur shënuan golat ndaj

Paragjykimet dhe etiketimet janë prezente në shoqëri dhe shpesh përballja ndaj tyre jo gjithmonë është e thjeshtë. Dhe e dini, habitesh më shumë kur përballësh me to në mënyrë më të papritur. Beyonce dhe Jay Z më bënë të mendoj për gjithë sagën e tyre dhe zezakëve dhe dëshirën për arritje dhe vlerësim. Futbollistët Xhaka e Shaqiri më bënë të mendoj se si shqiponja në Ballkan përjetohet si kërcënim nga disa dhe jo simbol i esencës së qenies shqiptare. Kurse reklama e birrës që ka në fokus të ndryshmen me bëri të mendoj se sërish kërkimi i secilit pa dallim ndryshueshmërisë që ka, për barazi e respekt është konstant



Serbisë. Por, edhe ata si Beyonce dhe Jay Z i lidh i njëjti pasion dhe dashuri e madhe për përkatësinë e tyre, për historinë e tyre, për jetën dhe suksesin e tyre. Video e artistëve amerikan me ngjyrë është një ulërimë dhe dëshmi për të kaluarën dhe respekt për arritjen. Shqiponja e djemve është e njëjta, një emocion dhe krenari që lidhet me gjithë historinë personale dhe kolektive. Shndërrorohet pa dashur në mision dëshira për të treguar krenarinë.

Çifti Carters ka pasur një ekip të tërë të mendojë e dërgojë mesazhet me detaje të kuruara deri në perfeksion, kurse perfeksioni i djemve ishte rastësia dhe dëshira për fitore. Perëndia e tyre nuk ishte Nike në momentet e golave, por shqiponja që iu fali krahët e krenarisë. Sado të pa krahasueshme të duken këto dy momente që po analizoj sërish i lidh dëshira për të shfaqur origjinën me krenari dhe në asnjë mënyrë si shpërthim agresioni ndaj të tjerëve. E gjitha ka të bëjë me veten, me respektin e vuajtjes personale dhe kolektive dhe arritjes së madhe.

Shqiponja nuk është një simbol i krijuar për inat të të tjerëve, është simboli, Perëndi e asaj që ne jemi. Është krenaria me të cilën sh-



Nga
Nazim RASHIDI

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 28 qershor | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

faqet dhe i përkulet edhe dhimbja edhe gëzimi shqiptar. Por, si mund të përshkruhet kjo ndjesi në mes të një loje futbollit kur asgjë s'ka të pararenduar sepse gjithçka në atë fushë karakterizohet nga pa parashikueshmëria.

Por edhe futbollistët edhe artistët shpesh mund të përballen me paragjykimin, më të lehtë karakteristike njerëzore kur gjykohej tjetri. Ndërkohë po ky ves luftohet nga të gjitha anët. Madje edhe në reklama. Në mesin e debateve për shqiponjën, artin, mesazhet, të qëlimshme, rastësore, mirëkuptimet, keqkuptimet që ngjallën, më doli përpara një reklamë. Për birrë por kundër paragjyqimeve.

BIRRA

Reklama si medie personalisht më është dukur gjithmonë interesante dhe hapësirë e jashtëzakonshme kreative. Ky element merr peshë kur porositesit me anë të saj nuk duan thjeshtë të shesin produktin që kanë, por paralelisht të përçojnë edhe mesazhe të tjera. Reklama e birrës kishte dhe kauzën "Pa paragjyqime, pa etiketa". Miku im, filozofi Artan Sadiku në një prezantim pak ditë më parë, për rolin e artit në shoqëri, thoshte se arti me format e ndryshme të shprehjes (pra edhe nëpër reklama) duhet të shokojë, por dhe të nxisë mendim dhe progresivitet.

Kur sheh reklamën e birrës në fjalë, që jo domosdoshmërisht ndjell etje, sërish nuk është se të le të qetë dhe nuk të shtyn për të reflektuar. Paragjykimet dhe etiketimet janë prezente në shoqëri dhe shpesh përballja ndaj tyre jo gjithmonë është e thjeshtë. Dhe e dini, habitesh më shumë kur përballësh me to në mënyrë më të papritur.

Beyonce dhe Jaz Z më bënë të mendoj për gjithë sagën e tyre dhe zezakëve dhe dëshirën për arritje dhe vlerësim. Futbollistët Xhaka e Shaqiri më bënë të mendoj se si shqiponja në Ballkan përjetohet si kërcënim nga disa dhe jo simbol i esencës së qenies shqiptare. Kurse reklama e birrës që ka në fokus të ndryshmen me bëri të mendoj se sërish kërkimi i secilit pa dallim ndryshueshmërisë që ka, për barazi e respekt është konstant. Kjo ndjesi do të shprehet në vazhdimësi, do të përforcohet sa herë shfaqet kërcënim dhe do të theksohet sa herë ka ndjesi mposhtjeje dhe urretje nga të tjerët. Kjo vlen për të gjithë dhe do të vijë në art, në sport qoftë dhe reklama sepse realizimi i njerëzve si individë apo në grup, barazia dhe respekti janë nevojë thelbësore njerëzore.

Prandaj me një birrë (nëse e pini), duke dëgjuar muzikë s'ka pse mos t'i kënaqesh shqiponjave të djemve, por gjithnjë me shprese se herës tjetër s'do lindin kaq keqkuptime, nga të gjithë!

(Autori është kolumnisti i rregullt i gazetës KOHA)

Haxhi baba, i tëri hundë e buzë!

Ky "Haxhi Baba" i mëhallës sonë, që është më i moshuar se unë, qysh prej vaktit kur është pajisur me titullin haxhi nuk gënjen më! Në krahasim me mua është paksa më i ngatërruar në fiqir..., por ama që është më qerrata se unë, është pa diskutim. Një ditë "karasabah" ishte shndërruar i tëri hundë e buzë dhe lëre që e kishte "karashtis" toptan mendjen, por edhe me shumë të drejtë i kishte "kërcyer kandari" nga një shkrim imi paraprak që, sipas tij, kishte dalë joseriozi në një gazetë shqip që botohet në shtetin e Republikës së Maqedonisë Veriore apo të Veriut (do ta kryqëzosh si Veriore a si eVeriut mbetet njësoj tekefundit, është një llogar dhe kurrëgjë tjetër)...që me demek, sipas tij, vështrimi përfundimisht nuk paskësh çuar peshë! Ky haxhi baba para se të më bënte "selame", pa një pa dy, pos të tjerash, më tha: "Hej ti, miku, bëj kujdes në do të llafosesh sot, ki parasysh se mua më ka ikur avdesi, andaj peshoje xhevapin!" "Eh, seç më zuri belaja! Aman miku, po ku më gjeti haxhi baba të bëjë talljen" me mua, po si nuk gjeti një tjetër..., po pse më mori për "ters dhe për inat". Ky në asnjë mënyrë nuk e ka ndërmend "të dërdëllisë" dhe për këtë parashitje pyetjen e dytë: "Ti, o do të bësh opinione serioze, o do t'i sikteris edhe ato që do të duken në vijim!" Edhe unë, ashtu hundë e buzë, ia ktheva: Do më lejosh që edhe kësaj radhe kësaj "shkarravinë" t'ia "ndërti a t'ia ngul" me atë të folmen tënde, me atë fjalorin e gjuhës së sotme shqipe dhe pak me atë tonën krahinore. Tekefundit, do ta bëj shkrimin me "porosi", nuk do ta ndërtoj kullën e marrëzisë së shqiptarëve, nuk do ta bëj shkrimin për zhurmën e madhe shqiptare, nuk do ta bëj shkrimin as për ato "armët e burrërisë" tënde, "armë" që i ke të varura në këmbët e tua, nuk do bëj shkrimin as për agallëkun tënd, thjeshtë do ta bëj ashtu si do ti, i thashë haxhi babës, i gjithi hundë e buzë!

Sikur më bëri..., prej "budallai" dhe më tha: "Do të shkruash për darkën që hanë myslimanët pas agjërimit të ditës në kohën e ramazanit, do të shkruash për filozofinë e iftarit si dhe për mesazhet që përcjell ky institucion sa human, po aq emancipues, do të shkruash edhe për topin e kandarit!" Ky haxhi baba kujton se unë mund t'i bëj të tërat. Po si do t'i bëj veças këto! "Mos ki dert. Fillimisht të gjithakëto mesele futi në një thes dhe mandej lakoji një nga një ashtu me da-



shuri, me ustallëk, me qejf dhe me inat!" Dhe kur e pyeta se nga na doli thesi dhe kush është topi i kandarit, ma ktheu: "Të gjithë ne jemi një trastë e madhe. Mos harro se neve na thonë se vjedhim me thes, ne drejtin e fusim në thes kur duhet e kur nuk duhet, ne shqiptarët për inat të fqinjtimund të hamë një thes me kripë, ne mund të mbushim një thes me broçkulla, ndonëse nuk kemi aq shumë marrëzira, ne mund të mbushim një thes me premtime të bujshme po edhe boshë, ne mund të mbushim një trastë me gënjeshtër edhe përtej të vërtetave tona, ne mund të mbushim një thes me pleshta, ne gabojmë me thes, ne fitojmë me thes, ne bëjmë çallëme me thes, ne kemi çrregullime mendore me thes, ne kemi një thes me llafë, po të duan fqinjët tanë, po edhe Europa dhe Amerika, ne edhe minaren mund ta fusim në thes, ne mundta bëjmë edhe thesin e zbrazët që të qëndrojnë më këmbë! Fatkeqësisht, ne shqiptarët mund të thyejmë kokën tonë, por që harrojmë se thesin e kemi të grisur..., e të tjerë thasë!" Këtë shprehjen "topi i kandarit", me të cilën identifikohet haxhi baba, lëre që ma la peng, por edhe nuk më dha shpjegime shtesë.

Ky haxhi baba mbase kishte shumë të drejtë kur më sugjeroi të shkruaj me dashuri, me usta-llëk, me qejf dhe me inat, edhe për institucionin e shenjtë, siç është iftari. Sikur me të drejtë donte të thotë se muajin e bekuar të agjërimit e shndërruam në tallava, sikur atë e bëmë paçavure me lloj-lloj tryezash të iftarit për njerëz me kollare që hiç nuk kanë haber për filozofinë e mesazheve që përcillen nëpërmjet tyre. Sikur e denigruam deri në fund iftarin dedikuar politikanit, biznesmenit, folk-patriotit dhe së fundi edhe për njerëzit me xhepa të thellë, për njerëzit që kanë

hajt të mos themi edhe kombëtar, ndonëse asnjërit prej tyre nuk i pranohet nijeti! Ato sofrat iftaresh u shtruan gjithandej! Gjithandej ku kishte hapësira boshe! Gjithandej..., buzë trotuarëve, brenadadhe jashtë restoranteve të mëdha dhe të kategorisë së parë, rreth vendesh..., gjithandej nëpër kodrina të gjelbëruara, gjithandej rreth liqenesh e lumenjsh e tjerë, gjithandej! Si nuk i shkoi ndërmend asnjërit që këto sofrat iftaresh t'i shtrojnë larg syrit të skamnorit, larg shikimit të jetimit, larg atyre që edhe nuk mundën ta përfytyrojnë begatinë e sofrës në fjalë..., si nuk u shkoj ndërmend njerëzve që i dalin zot institucionit të Ramazanit dhe në veçanti të iftarit, që të thonë "O ju besimtarë, bëni kujdes me sofrat e mëdha!..., bëni kujdes me fukarenjtë..., edhe ata janë me shpirtra të ndjeshëm..., ani se asnjëherë nuk u ulën pranë një sofrë iftari tuajës! Miku im i dashur, pa më thuaja hiç nuk na shkoi mendja që një pjesë të mjeteve kushtuar këtyre sofrave të begata t'i destinohet për studentët dhe nxënësit skamnorë dhe pa prindër. A hiç nuk e arsyeton idenë karshi solidaritetit..., a hiç nuk të ra ndërmend se institucioni i tillë, siç është ramazani dhe iftari, nuk mund të ushqehet kësosoj! Jazëk na qoftë! Më ndjeni, unë nuk bëra moralistin prej aristokrati, prej myslimani e as moralistin e mërziqshëm! Thjeshtë diktova mesazhin që neve na duhet! Ky haxhi baba i mëhallës sonë, që është më i moshuar se unë dhe që është shndërruar i tëri në hundë e buzë, gjatë gjithë ndërtimit të këtij shkrimi më "tregoi" se në ç'vend ndahet muhabeti dhe deri ku mund të shkoj kufiri i një marrëzie! Kjo ishte filozofia e "topit të kandarit" të njeriut që ka mendje të "karashtisur!" Ndoshta ngandonjëherë ia vlen të jesh i marrë! Kushedi!



më shumë sesa (nuk) u mjafton. Sikur qëllimisht po edhe fatkeqësisht asnjë të tillë nuk e shtruan për skamnorët a edhe për familjarët e dëshmorëve, për jetimet e luftës, për studentët nga Lugina, për pastruesit e kasabasë sonë, për ata njerëz që dikur moti kërkonin lirinë e vonuar të vatanit..., për zjarrfikësit, për... Sikur për inat harruam të shtrojmë një sofër iftari edhe për mësuesin, sikur na mbyti provincializmi..., sikur na erdhi turp të ulemi bashkë në një sofër me njerëzit që nuk na njohin e që i konsiderojmë për jabanxhi, ani se janë punëtorë krahu të ardhur nga shteti amë! Sofra prej iftaresh kolektive, shtroi edhe kumarxhiu, edhe fajdexhiu, edhe kleptomani edhe ai që mohon identitetin e tij fetar,

Nga
Fadil LUSHI





Përse flemë?!

Ajo çka tashmë dihet me siguri, është fakti që gjumi luan një rol parësor dhe të domosdoshëm në jetën tonë dhe na shërben për të pasur marrëdhënie më të mira me botën e jashtme. Pyetja përse flemë, ka intriguar gjithmonë shkencëtarët, të cilët janë thelluar hap pas hapi ndërsa eksperimentet e shumta nxjerrin në pah rëndësinë e jashtëzakonshme që kanë për mirëqenien dhe vetë jetën tonë, orët e errësirës së natës. Por, çfarë ndodh kur ne jemi në gjumë? Për t'u përgjigjur kësaj pyetjeje ka disa teori. Gjatë gjumit, truri ynë përjeton dhe përpunon të gjitha përvojat e ditës. i çmonton, i kategorizon dhe i vendos ato në zona të ndryshme të tij. Dhe aty qëndrojnë në formën e kujtimeve. Ky lloj spastrimi është ajo ndjesi që në mëngjes e quajmë "çlodhje", apo "mendje të lehtë".

"Gjumi është një magji më vetë", thotë professor Robert Stickgold, që konsiderohet si një nga pionierët e studimeve në këtë fushë. Ai tregon se organizmi ynë i të menduarit, gjatë natës, nuk kufizohet vetëm në vendosjen rregull në tërësinë e ngjarjeve që përjetojmë gjatë ditës, por në shumë më tepër.

Sipas tij, gjatë natës bëhet përpunimi i përvojave dhe në njëfarë mënyre integrimi i përvojave të reja jetësore me ato të vjetra. Një gjumë i mirë na mban në formë dhe na ruan nga sëmundje të ndryshme të zemrës, të cilat në mungesë të tij do të agravoheshin dhe do të ishin më të shpeshta. Kështu, mungesa e gjumit, ose mospopja me gjumë e rrit hormonin e grelinës që është i lidhur me oreksin dhe ul atë të leptinës që ka të bëjë me ngopjen. Mungesa e pushimit jo vetëm aktivizon gjithë mekanizmin e stresit, por krijon edhe probleme të vërteta fizike.

Patë në këtë këndvështrim gjumi konsiderohet prej studiuesve një nga tri shtyllat kryesore të shëndetit të njeriut së bashku me dietën dhe ushtrimet fizike.

DHJETË ARSYE TË MIRA PSE DUHET TË PINI UJË



Të pish më shumë është më mirë, të hash ushqimet e duhura dhe të përfitosh nga banjot rigjeneruese përmirëson problemet e mbajtjes së ujit, ka efekte pozitive në metabolizëm dhe e bën lëkurën të ndritshme dhe më elastike. Këtu është një manual i vogël për një bukuri dhe shëndet të bazuar në ujë.

- Dita e mirë shihet që në mëngjes: Një zakon i mirë është të pini një gotë uji sapo të zgjohe- ni, sepse gjatë natës trupi humbet kripërat minerale themelore. Në një stomak bosh, uji i ngrohtë gjithashtu do të kontribuojë në funksionimin e duhur të zorrëve.

- Përsheptimi: Uji i pijshëm mund të ndihmojë edhe në dieta, sepse ka efekte pozitive në metabolizëm dhe ndihmon trupin për të eliminuar toksinat.

- Vazhdoni me aroma: Nëse uji duket tepër i pashije dhe nuk na inkurajon, ne mund ta shijojmë atë me fruta sezonale. Në mbrëmje mbushim një enë me luleshtrydhe ose pjeshkë, ose madje edhe feta limoni me lëvore: në

mëngjes ne do të kemi një ujë të shijshëm dhe me shumë kripëra minerale.

- Një meze shumë e mirë: Studimet e kohëve të fundit tregojnë se të pijmë disa gota ujë para se të ushqehemi ndihmon në procesin e humbjes së peshës, duke favorizuar ndjenjën e ngopjes. Për këtë arsye, ne shfrytëzojmë mundësinë për një rimëkëmbje të formës me ujë dhe limon: hidratues, i freskët dhe i shëndetshëm.

- Përdorni dinakërinë: Çdo ushqim përmban ujë në përmasa të ndryshme. Sidomos në verë, është më mirë të preferoni sallatë, perime dhe fruta, madje edhe të shtrydhura ose të centrifuguara. Gjëja e rëndësishme është të qëndroni të hidratuar dhe të mos humbni mineralet.

- Asnjëherë pa të: Madje edhe në zyrë, ne e mbajmë trupin tonë të hidratuar, ndërsa pimë ujë gjatë ditës. Riintegrimi i kripërave minerale do të jetë shumë i dobishëm për të luftuar lodhjen dhe për të kapërcyer dhimbjen e kokës.

-Mos më harro: Nëse nuk jemi

Ne jemi çfarë hamë, por mbi të gjitha jemi çfarë pimë dhe uji është mjeti i të gjitha substancave dhe elementeve vitale në trupin e njeriut. Nëse mendojmë se trupi ynë përbëhet kryesisht nga uji - më shumë kur jemi më të rinj - në përqindje që arrijnë deri në pothuajse 75%, kuptohet menjëherë se ruajtja e hidratimit të duhur është thelbësore

mësuar të pimë, mund të ndodhë që të harrojmë plotësisht të pimë ujë. Në këtë rast duhet që gjithmonë të mbani një shishe në dorë ose në çantë: më mirë me bollëk sesa pa të.

- Ka mënyra dhe mënyra: Për të favorizuar kullimin dhe për të ndihmuar në pastrimin e organiz-

mit është më mirë të pini gllënjka të vogla të shpërndara në kohë. Pra, nëse ne zakonisht e pimë të gjithën në një gllënjë, le ta marrim lehtë dhe të shmangim zbrazjen e gotës sikur të garonim për 'guinness'.


- Edhe në kuzhinë: Për të rritur fuqinë e ngopjes dhe për të promovuar restaurimin e lëngjeve, ne shtojmë ujë në gatimet tona. Supërat dhe perimet janë gjithashtu të shkëlqyera edhe po të hahen të ftohta, dhe janë shumë të shijshme, ekonomike dhe të shpejta për t'u përgatitur.

- E mbyllim me bukurinë: E dinin shumë mirë edhe romakët e lashtë: uji termal është shumë i dobishëm për trupin tonë, lëkurën dhe nyjet. Nga ana tjetër, nuk është rastësi që banjot termale të quhen "spa": është akronimi i 'Salus Per Aquam', që do të thotë shëndet përmes ujit. Vlerat terapeutike të mikroelementeve mund të shërojnë sëmundje të ndryshme, për të mos përmendur se zhytja në ujë ka një efekt të mrekullueshëm relaksues dhe rigjenerues.

ALERGJIA, si të dallojmë simptomat

Shumë njerëz mendojnë se alergjia ndaj ushqimit dhe mospunimi i ushqimit nga organizmi janë e njëjta gjë. Por kjo nuk është e vërtetë. Mospunimi i një lloj ushqimi nga organizmi është ç'rregullim metabolik që nuk ka lidhje me sistemin imunitar. Për shembull kur disa njerëz pinë qumësht, bëhen me dhimbje barku dhe ndjejnë fryrje. Kjo ndodh, sepse organizmi nuk e pranon një ushqim të tillë, stomaku nuk është në gjendje ta përpunojë atë, pra problemi lidhet me metabolizmin.

Ndërsa alergjia është diçka tjetër: në përpjekje për të mbrojtur organizmin, sistemi imunitar krijon imunoglobulinë, lloj antitropash, të cilët reagojnë ndaj ushqimit dhe kimikateve të tjera që bëhen shkak për simptoma të alergjisë që mund të prekin sistemin e frymëmarrjes, sistemin e



Klima e ngrohtë favorizon shfaqjen e simptomave të alergjisë. Por çfarë ndikon në shfaqjen saj, simptomat më të cilat shoqërohet dhe si t'i shmangni alergjenët. Ja çfarë këshillojnë ekspertët

tretjes, lëkurën dhe sistemin kardio-vaskular.

Simptomat: Ënjtje të buzëve dhe gjuhës, vështirësi në frymëmarrje, përhapje të skuqjeve, të vjella, marrje fryme me zor, një rënie të menjëhershme të presionit të gjakut dhe rrëzim. Testimet e shpeshta, sy të skuqur, rrjedhje të

hundëve, shpesh ndodh edhe që hundët të bllokohen, njolla në lëkurë, etj... Trajtimi për alergjinë nga ushqimi është shmangia plotësisht e ushqimit që shkakton alergjinë. Njerëzit që kanë një alergji të rëndë, duhet të tregohen të kujdesshëm për të shmangur dhe madje edhe prekur ushqimin ose ngrënë "gjurmë" të saj, që janë të pranishme në ushqimet e përpunuara. Dietologu mund t'ju tregojë sesi të njihni përbërësit përkatës në etiketat ushqimore.

Megjithatë, nëse rastet alergjike janë shumë të shpeshta dhe ju ndjeheni të kërcënuar nga këto shqetësime, duhet t'i drejtoheni mjekut specialist dhe të merrni mjekimet e duhura. Edhe pse për momentin trajtimet nazele janë më efikase dhe më të përdorura, më përpara duhet të konsultoheni me mjekun për të parë se çfarë është më e mira për ju.



Pesëvjeçarja që s'kreh dot flokët



Kur Taylor McGowan ishte pesëmuajshe, asaj filluan t'i dilnin flokë të verdhë, por aspak të butë si të bebeve. Me kalimin e kohës, flokët e saj të ndritshëm bionde vazhduan të rriteshin, të dendur dhe të ashpër. Prindërit e vogëlushes e kuptuan që diçka nuk shkonte dhe mjaftoi një vizitë e vetme tek pediatri për të mësuar se vajza vuante nga sindroma e flokëve që nuk krihen.

Në të gjithë botën numërohen rreth 100 raste dhe Albert Einstein ishte njëri prej tyre. Cara dhe Tom, nga Çikago, Illinois, kërkuan ekspertizën e profesor Regina Betz. Profesor Betz në Universitetin e Bonit në Gjermani, është aktualisht figura kryesore në hulumtimin e kësaj sindrome. Ekipi i saj në Institutin e Gjenetikës Humane ka deklaruar se gjendja shkaktohet nga një mutacion gjenetik dhe është e trashëgueshme.

Fillimisht prindërit e pesëvjeçares u përpoqën t'i drejtonin flokët vajzës, por më pas ata i lanë të rriteshin natyrshëm. "Kemi provuar të gjitha llojet e produkteve, por më pas menduam se ajo duhet ta dijë që është e bukur siç është! E përsosur dhe unike. Ne duam që ajo ta pranojë veten dhe të mos përpiqet të ndryshojë për të tjerët" thonë prindërit e pesëvjeçares së ëmbël.



Historia e GIJOTINËS, SHPIKJA QË LAU ME GJAK REVOLUCIONIN

Të parit që iu pre koka në Francë ishte Nicolás Jacques Pelletier, një vjedhës rruge më 25 prill 1792, i fundit ishte në 10 shtator 1977, Hamida Djandoubi, një emigrant tunizian që vrau ish të dashurën e tij. Megjithatë në mes të Revolucionit tehu ra mbi 1120 njerëz në Place de Concorde

"Gijotina është një kornizë me dy shtylla vertikale të bashkuar nga një trasversale që mban lart një teh çeliku në formë trekëndore". Ky shpjegim i ftohtë i manualit ka edhe të dhëna të tjera. Shtylla trasversale quhet chapeau (kapele). Tehu i çelikut me një peshë plumbi prej 60 kg quhet mouton. Gracka prej dy gjysëm hënash e pjesës së pasme quhet fenetre. Prapa një mbështetëse druri që shërben si stol. Një ekzekutim vonon më pak se një minutë...

Siç mund të dihet apo e të besohet gijotina është e lidhur me revolucionin francez, 1789 dhe me Francën deri në vitin 1981, vit në të cilin presidenti François Mitterrand shfuqizoi dënimin me vdekje, por është përdorur edhe në Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikë, Suedi, Itali dhe Gjermani deri vonë në shek XX. Në të vërtetë zakoni apo kënaqësia e të prerit të kokave vjen që prej së largu. Me shpatë apo me sëpatë (instrument i parapëlqyer i Henrit të VIII dhe nga shumë mbretër të tjerë...) Një vështrim i thjeshtë mbi këtë instrument dhe të tremb. I ngjan një përbindëshi, një fantazme, një hijeje djalli dhe nga ana tjetër ndriçimi i tehut, një version



Kirurgu francez, Joseph Ignace Guillotin, deputet në Asamblenë Kombëtare, e rekomandoi në tetor të 1789 për ekzekutimet në zëvendësim të metodave të tjera tradicionale dhe më pak të frikshme



modern i zonjës Kosë. Megjithatë mbretëritë dhe vendet që e adoptuan e bënë për arsye humanitare mirë të arsyetuara; justifikim tekstual i disa shkencëtarëve. Është e kuptueshme sepse para zjarrit, gjymtimit, varjes ose kombinimeve të mbytur, i varur dhe i gjymtuar - praktikë angleze, ose rrahjes së ngadaltë me kamzhik në varje, gijotina duket një version i dalë nga bisturia. U rrit dhe u përsos shkencërisht, sepse në fillimet e saj tehu ishte i drejtë dhe prerja e tij horizontale që ishte një gabim i projektimit, sepse disa qafa rezistonin ndaj më shumë se një rënieje dhe ceremonia makabre duhej të përsëritej. Fatmirësisht në emër të mëshirës dhe pas disa provash mbi dele, kufoma dikush më në fund e kuptoi - Eureka! - se tehu kërkonte një formë shumë të civilizuar nga pak në shumë. Kjo formë garantonte një prerje perfekte dhe pa vuajtje të panevojshme (një mënyrë tjetër e të shprehurit kjo nga ekspertët). Kish-te edhe fletën e shpjegimit: i burgosuri shtrihet mbi stolin e pasmë dhe shtyhet tek gracka, ku qafa mbetet e kapur. Xhelati tërheq një sustë dhe tehu bie mbi qafë duke e ndarë

kokën nga trungu në nivelin e C4, vertebrës cervikalë të katërt. Koka e ndarë merret në një trastë lëkure dhe jo në një shportë siç shihet në disa filma. Kinemaja gjithmonë e ekzagjeron. Shkojmë në zemër të çështjes; kirurgu francez, Joseph Ignace Guillotin, deputet në Asamblenë Kombëtare, e rekomandoi në tetor të 1789 për ekzekutimet në zëvendësim të metodave të tjera tradicionale dhe më pak të frikshme.

Në fakt, doktori i mirë nuk e shpiku ai gijotinën, makina të ngjashme njiheshin qysh prej shek XIII në Gjermani, Skoci, Angli dhe në shtetet papnore. Megjithatë ky emër gjithmonë do të mbajë stigmën të lidhur dhe të përsëritur me shtypjen dhe me mijëra litra gjak të derdhur gjatë revolucionit francez. Në fakt mentor i përsosjes, me detyrën e sekretarit të Akademisë së Kirurgjisë, doktor Antoine Louis, i cili ia ngarkoi këtë detyrë një njeriu shumë larg vdekjes, prodhuesit të kordave për piano Tobias Schmidt-it, gjerman që u kë-

shillua nga njeriu i duhur, një mik i tij Charles-Henri Sanson, xhelati i Parisit. Pasi u realizua makina perfekte, Asambleja Kombëtare unanimisht shpjegoi se u ndërmor përdorimi i gijotinës në mënyrë që vdekja të ishte e barabartë për të gjithë pa dallim rangi dhe shtrese sociale. E tmerrshme, por demokratike, sepse deri në atë ditë vetëm aristokratët gëzonin privilegjin e vdekjes pa agoni, prerje koke të pastër me shpatë ose sëpatë të ekzekutur nga xhelati profesionist. Të parit që iu pre koka në Francë ishte Nicolás Jacques Pelletier, një vjedhës rruge më 25 prill 1792, i fundit ishte në 10 shtator 1977, Hamida Djandoubi, një emigrant tunizian që vrau ish të dashurën e tij. Megjithatë në mes të Revolucionit tehu ra mbi 1120 njerëz në Place de Concorde. Për shekuj shëtit legjenda tunduese se doktor Guillotin ishte i pari që u ekzekutua nga makina e vet. Informacion i rremë: ai vdiq nga antraksi në 26 mars 1814 në paqe në shtëpinë e tij...

Zvicra, e para në botë për gjoba në trafik

Rreth 3400 njerëz vdesin çdo ditë në aksidente rrugore, duke çuar në rreth 1.25 milionë vdekje në nivel botëror çdo vit. Një e treta e këtyre vdekjeve shkaktohen nga shpejtësia, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Për të ulur numrin e aksidenteve rrugore, disa vende po vijnë me mënyra inovative për të ndaluar shpejtësinë e madhe me të cilin lëvizin drejtuesit e mjeteve. Finlanda po ndjek një metodologji për vënien e gjobave ditore që përllogarit në bazë të të ardhurave të drejtuesit të mjetit që udhëton me shpejtësi mbi normat e lejuara.

Sa më e lartë të jetë shpejtësia mbi normën e lejuar e një shoferi,

aq më i madh është numri i gjobave ditore që do të marrin. Finlanda nuk është i vetmi vend që aplikon të ashtuquajturin 'dënim progresiv' për gjobat e shpejtësisë. Zvicra, po ashtu përdor një sistem të ngjashëm dhe aktualisht mban rekordin botëror për gjoba. Britania e Madhe është një tjetër vend e cila vendosi masa të ashpra për shpejtësinë në vitin 2017. Shoferët u gjobitën deri në 175% të të ardhurave të tyre javore, varësisht ashpërsisë së veprës së kryer. Megjithatë, gjoba është e kufizuar në 2500 funte.

Ndërsa vendet evropiane udhëheqin për gjoba të larta të shpejtësisë, ato po ashtu 'praktikojnë'



edhe sekuestrimin e makinave si dhe burgosjen e shoferëve kur shkelin në mënyrë të përsëritur li-

mitin e shpejtësisë. Kjo ndodh në vende si Francë, Finlandë, Spanjë dhe Gjermani.



Rama: Kemi datë për negociatat, në korrik vjen ekipi i KE

Kryeministri Edi Rama i është përgjigjur akuzave të opozitës lidhur me datën e negociatave. Rama tha se opozita punoi ditë natë kundër vendit, por megjithatë morëm një vendim pozitiv për hapjen e negociatave verën tjetër. Rama u shpreh se me këtë opozitë nuk kemi se çfarë të diskutojmë. Kryeministri duke iu drejtuar opozitës i ironizoi duke thënë "O Zot pse nuk e kufizove budallallëkun, pse e lë pa kufij". "Duhet të pajtohem me këtë fatkeqësi, nuk kemi opozitë", tha Rama në Kuvend.

"Kjo është opozita e vetmë në historinë e procesit të integritimit që punon ditë natë kundër vendit të vet sa herë hap gojën dhe nxjerr fjalë në gjuhë të huaj. Nuk e thëm unë, nuk e thëm i ne, e thonë miqtë e Shqipërisë. Çfarë mund të debatojmë me këtë opozitë? Të debatojmë pse opozita jonë është e vetmja që thotë Shqipëria dështoi, ndërsa Këshilli European poston edhe kartolinë urimi për shqiptarët. Ne nuk kemi punë me këta, pasi kemi shumë për të bërë në këtë stad të ri", tha Rama. Kryeministri deklaroi se ka marrë ftesë për të shkuar në Bruksel. "Kam marrë ftesë për të shkuar në Bruksel për të filluar diskutimin për punën përgatitore që është puna e gjithë procesit analitik për hapjen e negociatave. Në korrik vjen ekipi i Komisionit European", deklaroi Rama.

STOP PËR VULININ



Në Gazimestan dje festuan festën ortodokse të "Vidovdanit". Shumë pelegrinazh nga Serbia kanë paralajmëruar ardhjen e tyre në Kosovë. Madje, një ardhje të tillë e pati paralajmëruar edhe ministri serb i Mbrojtjes Aleksander Vulin, hyrja e të cilit është ndaluar nga Qeveria e Kosovës. Aksionin për ndalimin e tij e ka konfirmuar edhe Policia e Kosovës. Besim Hoti, zëdhënës i policisë për rajonin e Mitrovicës ka thënë për Gazetën Alo se do ta zbatojnë vendimin e Qeverisë për ndalimin e hyrjes së ministrit serb, Aleksander Vulin.

"Nuk do ta lejojmë hyrjen e Ministrit serb të mbrojtjes, Aleksandar Vulin në Kosovë sepse ai është vendim i Qeverisë që i refuzohet hyrja dhe policia duhet me zbatu atë vendim pa diskutim", ka thënë Hoti. Hoti, ndër të tjera thotë se Njësia Speciale e Policisë së Kosovës e ni-

sur sot ën drejtim të Mitrovicës së Veriut është përgjegjëse për sigurinë dhe mbarëvajtjen e kësaj feste. Mediat serbe kanë raportuar për vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndalimin e hyrjes së ministrit serb të mbrojtjes Aleksander Vulinit, në Kosovë, transmeton Gazeta Alo. Në raportimet e medieve serbe thuhet se Vulin nuk mund të shënojë festën ortodokse në Gazimestan. Tutje në raportimet e tyre thuhet se Policia e Kosovës ka ndërmarr aksion të veçantë për këtë ngjarje.

Ndalimin e hyrjes së ministrit serb Aleksander Vulin, e ka dënuar ashpër Qeveria e Serbisë duke thënë se Prishtina zyrtare nuk po respekton marrëveshjet për stabilizim të marrëdhënieve të dy vendeve. Ndryshe sot në Kosovë priten të vijnë pelegrinazh serbë për të festuar festën e "Vidovdanit".

Policia e Kosovës do të bëjë mo-

nitorimin e kësaj ngjarjeje.

Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë e ka quajtur sot skandaloz vendimin e Kosovës për ndalimin e vizitës së ministrit serb Mbrojtjes Aleksandar Vulin në Kosovë gjatë manifestimeve serbe për ditën e Vidovdanit paralajmëruar për sot, transmeton Koha.net. Sipas kumtesës që e publikon FoNet, Zyra... e ka fajësuar edhe Bashkimin European për ndalimin e kësaj vizite.

"Është e qartë se ky vendim është marrë në koordinimin ndërmjet Kosovës dhe Shërbimit European për Punë të Jashtme me qëllim që të nënçmohet Serbia", thotë kumtesa e Zyrës. Ky vendim, shtohet në kumtesë, vjen pas pranimi të Kosovës në takimin e Brukselit se përkrah marrëveshjet e arritura deri më tash dhe se sillet si palë e rëndësishme dhe e respektueshme ndal palës me të cilën dëshiron marrëveshje.

Me fotografi të Millosheviqit e Mlladiqit serbët festojnë në Gazimestan



Disa qindra serbë janë të pranishëm në manifestimin e Vidovdanit në Gazimestan, disa kilometra larg Prishtinës. Disa prej tyre kanë provokuar me mbishkrim

me nacionaliste si dhe figura të kriminelëve serbë, Slobodan Millosheviq dhe Ratko Mladiq. Aty nuk kanë munguar as edhe flamuri i shtetit të Rusisë, transmeton lajmi.net. Beteja e Kosovës është zhvilluar në vitin 1389 dhe përkujtohet me ceremoni për çdo vit në datën 28 qershor. Qytetarët e mbledhur mbanin të veshur bluza me mbishkrim "Kosova është Serbi" dhe flamuj të Serbisë. Këtë herë nuk ishin të pranishëm përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Beogradit. Policia ka ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë për tubimin publik, si dhe ka garantuar siguri për pjesëmarrësit.

Rama është "Hamzai" i interesave të vendit

Pas fjalës kryeministri Edi Rama u largua nga salla e Kuvendit, ndërsa fjalën e mori Basha. Basha tha se Rama ka rritur eksportin e kriminit, drogës dhe emigracionit. Basha tha se Rama "do iu shesë sapunin për djathë, hapjen e negociatave për mos hapjen e negociatave". Basha e krahasoi Ramën me Kim Jong Un, i cili u tha qytetarëve të vendit të tij se Koreja e Veriut kishte fituar kampionatin Botëror

të futbollit. "Askush përveç Këshillit European nuk mund të hap negociatat. Rama brodhi cep me cep duke rrahur gjoksin se në Shqipëri nuk ka më krim dhe se Shqipëria i meriton hapjen e negociatave. Ne shkuam kryeqytet më kryeqytet, ku edhe në ato vende që e dinë shumë mirë që Edi Rama ka rritur eksportin e kriminit, eksportin e drogës dhe emigrimin", tha Basha.

Basha shtoi më tej se negocia-

tat nuk janë hapur, ndërsa theksoi se tashmë janë 13 kushte për të plotësuar dhe jo më 5. "Në Europë nuk shkohet duke mashtruar, duke gënjyer. Rama është "Hamzai" i interesave të vendit. Nuk janë më 5 kushtet fillestare, por tashmë janë 13. Shqiptarët duhet ta kuptojnë që vendimin për negociatat e hapin vetëm vendet anëtare. Gjermania ka insistuar jo vetëm do të ketë një kontroll rigoroz të 13 kushteve.



Për sa kohë të kemi një ministër të brendshëm duke ndihmuar vëllai e tij të lidhur me trafikun e drogës, një ish-ministër tjetër eksportues të drogës në Europë, qershori i vitit tjetër do të jetë edhe më keq se ky qershor", tha Basha.



KE do të nisë punën përgatitore me Shqipërinë

Zëdhënësja e Komisionit European, Maja Koçijançiq tha se menjëherë pas vendimit të Këshillit European, Komisioni do të nisë punën përgatitore me Shqipërinë ose siç njihet ndryshe procesi screening. Koçijançiq tha gjithashtu se Komisioni do të vijojë angazhimin për të mbështetur Shqipërinë në përpjekjet për reformat si përgatitje për të hapur negociatat.

Pas vendimit të vështirë pas orëve të gjata të diskutimit, Shqipërisë i është dhënë një shans i ri për në qershor të vitit 2019 për të hapur negociatat duke përbushur njëkohësisht edhe kërkesat e Këshillit European në këtë kohë.

Ky vendim u konsiderua si një vendim pozitiv nga Komisioni European ku eurokomisioneri, Johannes Hahn, pasi përgëzoi vendin tonë, u shpreh se Komisioni tashmë do të fillojë punën përgatitore për të ndihmuar Shqipërinë në hapjen e negociatave.

Ora News pyeti zëdhënësen e Komisionit European, Maja Koçijançiq, nëse puna përgatitore kishte të bënte me procesin screening dhe përgjigjia e saj ishte konfirmuese.

"Komisioni do të vijojë angazhimin për të shoqëruar Shqipërinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në përpjekjet e tyre për reforma, në përgatitjen e tyre për të hapur negociatat e pranimi në qershor 2019. Në këtë kontekst, Komisioni do të fillojë punën e nevojshme përgatitore. Kjo përfshin kontrollin teknik të legjislacionit (screening) si dhe përgatitjen e kornizës së negociatave", tha ajo.

Procesi i njohur Screening është një ushtrim tërësor që udhëhiqet nga Komisioni, për të përgatitur negociatat për anëtarësim.

Ky proces i jep mundësi vendit kandidat për t'u përshtatur më tej me legjislacionin european dhe lejon Komisionin të vlerësojë përgatitjen e vendeve kandidatë.

Tipikisht, ky proces zgjat më shumë se 1 vit dhe siguron një bazë të qëndrueshme për vendimin që do të marrin vendet anëtare për kapitujt dhe negociatave për anëtarësim.

Turqi, përfaqësimi i grave në parlament shënon rritje të lartë

Përfaqësimi i grave në Parlamentin e Republikës së Turqisë ka shënuar një rritje të lartë. Sipas rezultateve jozyrtare, në vazhdim të zgjedhjeve historike të 24 qershorit, një total prej 103 grave do të kenë ulëse në parlamentin me 600 vende. Kjo shënon një rritje të përfaqësimit të grave në Parlamentin turk në 17,1 për qind, krahasuar me përbërjen e kaluar kur përfaqësimi i tyre ishte 14,7 për qind.

Partia Demokratike Popullo-



re (HDP) udhëheq në përfaqësimin e grave, duke u përfaqësuar

në parlament me 25 gra nga gjithsej 67 ligjvënës të HDP-së,

transmeton Anadolu Agency.

Më pas vjen Partia për Drejtësi dhe Zhvillim (AK) në pushtet, e cila do të përfaqësohet me 53 gra në mesin e 295 ligjvënësve të saj. Pastaj vijon opozita kryesore Partia Popullore Republikane (CHP), e cila ka 18 deputete gra në mesin e 147 ligjvënësve të saj.

Partia e Lëvizjes Nacionaliste (MHP) ka pesë gra midis 49 ligjvënësve, si dhe Partia IYI në Parlament, ka tre gra midis 43

ligjvënësve. Sipas rezultateve zyrtare të zgjedhjeve të së dielës së kaluar, Partia për Drejtësi dhe Zhvillim (AK) fitoi 295 vende në Asamblenë e Madhe Kombëtare prej 600 anëtarësh. Partia Popullore Republikane (CHP) zë vendin e dytë duke fituar 146 vende, ndërsa Partia Demokratike Popullore (HDP) siguroi 67 vende, Partia e Lëvizjes Nacionaliste (MHP) 49 vende, si dhe Partia IYI 43 vende.



Samiti Putin-Trump mbahet më 16 korrik në Helsinki

Kremlini ka njoftuar se samiti në mes të presidentit amerikan, Donald Trump dhe homologut të tij rus, Vladimir Putin do të mbahet në Helsinki më 16 korrik.

Putin dhe Trump do të diskutojnë marrëdhëniet SHBA-Rusi dhe çështjet ndërkombëtare, ka njoftuar Kremlini sipas agjencisë së lajmeve TASS.

Shtëpia e Bardhë ende nuk e ka konfirmuar takimin, mirëpo Trump u ka thënë gazetarëve në Uashington më 27 qershor, se takimi ka mundësi të ndodhë pas samitit të NATO-s, që mbahet më 11-12 korrik.

Lideri amerikan ka thënë se dy presidentët do të diskutojnë për Ukrainën, Sirinë dhe "tema tjera" në takimin e tyre të parë.

Komentet e Trumpit para gazetarëve më 27 qershor në Uashington kanë ardhur pasi Këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, John Bolton, ka thënë në një konferencë për media në Moskë se Shtëpia e Bardhë dhe Kremlini do të nisin një varg njoftimesh më 28 qershor për të treguar datën dhe vendin e takimit të dy liderëve.

Presidenti SHBA-së, Donald Trump në mes të një konflikti të vazhdueshëm tregtar mbi tarifën me Bashkimi Evropian, e ka akuzuar BE-në se është krijuar vetëm për të përfituar nga SHBA.

"Ne i duam vendet e Bashkimit Evropian, por natyrisht Bashkimi Evropian është krijuar për të përfituar nga SHBA dhe ne nuk mund ta lejojmë këtë", ka thënë Trump, shkruan gazeta 'Politico', përcjell lajmi.net.

Trump ka dyfishuar pretendimet e tij se BE po e mashtron SHBA-në në tregti duke thënë se SHBA-ja vitin e kaluar ka humbur 15 milionë dollar në tregtinë me BE. Trump ka folur në lidhje me tregtinë me BE-në, në mes të përshkallëzimit të vazhdueshëm në luftën tregtare midis SHBA-së dhe

TRUMP: BE ËSHTË KRIJUAR QË TË PËRFITTOJ NGA SHBA



pjesës tjetër të botës, e cila filloi kur Trump goditi me një sërë tarifash për disa vende në fund të marsit. "Sepse na dërgojnë Merce-

desin, BMW-të, dhe produktet e tyre kurse ne kur bëjmë eksporte në këto vende përgjigjen - jo faleminderit nuk i marrim produktet e

juaja. Për të gjithë ata që mendojnë se kjo është tregti e lirë, kjo nuk është tregti e lirë", ka shtuar Trump.



Dukesha e Kembrixhit, Kate Middleton ka mësuar gjuhë arabe, ka lexuar ajete nga Kur'ani dhe po

Dukesha Kate ka lexuar arabisht ajete nga Kur'ani

ashtu ka festuar fundin e muajit të Ramazanit. Të gjitha këto ajo i ka bërë ndërsa ishte pjesë e një çerdheje në Jordani gjatë qëndrimit të saj bashkë me prindërit kur ishte fëmijë. Në një intervistë të realizuar me themeluesen e çerdes "Assahera" ajo ka dhënë një pasqyrë zbuluese për vitet e

hershme të Kate, duke thënë: "Rutina në mëngjes ishte që të gjithë fëmijët të uleshin në një rreth ku të gjithë do të këndonin Incy Eincy Spider, si në anglisht dhe arabisht". "Ne do të lexonim një ajet nga Kur'ani për të përmirësuar arabishten e fëmijëve dhe për të treguar tregime për shokët e Pro-

fetit, si Omar Bin Khattab. Ideja ishte përforcimi i koncepteve të tilla si respekti dhe dashuria", është shprehur ajo.

Familja e Kate ishin vendosur në Jordani në maj të vitit 1984, ndërsa ajo ishte vetëm dyvjeçare atë kohë kurse motra e saj ishte vetëm tetëmuajshe.

Kanada, supermarketi ku klienti merr atë që do, por paguan aq sa ka mundësi

Hapet supermarketi i ëndrrave ku mund të futesh, të mbushësh karrocën me atë që ke nevojë dhe pasi mbërrin në kasë mund të paguash atë që ke mundësi. Madje, edhe mund të mos paguash fare nëse nuk ke para në llogari bankare apo në xhep.

Është supermarketi i parë i "paguaj sa ke mundësi", i hapur në Toronto në Kanada, për të promovuar një etikë konsumi ushqimor jashtë logjikës së përfitimit. Kjo është një iniciativë e shefit Jagger Gordon, një "star" i kuzhinës kanadeze, që



jashtë çdo kriteri të tregut ka nisur idenë e re të "pazarit ushqimor": kur të mbërrish të kasa, paguan mbi bazën e kapacitetit ekonomik. Një sukses i menjehershëm me mbi

200 klientë të cilët që në ditën e parë kanë mbushur korridoret e rafteteve të supermarketit. Ideja për të hapur këtë supermarket ka lindur nga konstatimi se në Kanada një fë-

mijë në katër vuan mungesën e ushqimit. "E kam mësuar këtë për herë të parë kur vajza ime, që kishite shkuar në një festë me klasën në shtëpinë e një shoku u kthye në shtëpi para parashikimit. Arsyeja: Në shtëpinë e shokut të saj nuk kishite ushqim për të ngrënë mëngjesin. Zbulova se bëhet fjalë për një plagë të përhapur në të gjithë vendin" shprehet Gordon. Shifrat janë impresionuese: Në Kanada 4 milionë persona, mes të cilëve 1 milion e gjysëm fëmijë vuajnë urinë. Ndërkohë sasia e ushqimit që

shkon në plehra, si rrjedhojë e shpërdorimeve ushqimore por edhe zakoneve të gabuara në sistemin e shpërndarjes ku 70% e frutave e perimeve hidhen, çdo ditë arrin në tonelata. Në këtë mënyrë, Gordon ka nisur një cikël në marrëveshje me supermarketet e tjera dhe mbledh frutat e perimet, të mira por jashtë kalibrit, që përdryshe do të përfundonin duke u hedhur, dhe i vendos në dispozicion të supermarketit ku secili "merr atë që ke nevojë e paguan atë që mundet"./ Repubblica

STUDENTËT NDEROJNË EMRIN E IZET CURRIT

“Më duhet të theksoj se mbrojtësit e Currit kanë bërë krijime të mrekullueshme e të denja për ekspozitë jo vetëm në Shkup, por edhe në djepin e modës - Parisin, vendi ku çdo krijues i ri ëndërron të punojë. Republika e Maqedonisë është vend i pasur me njerëz të rinj dhe të talentuar, të cilët kërkojnë mundësinë për të shfaqur kreativitetin e tyre; njerëz, të cilëve nëse u jepet mundësia, do të jenë në ballë të shtëpive botërore të modës”, tha ministri Ademi

Në Hamamin e Daut Pashës të mërkurën në mbremje është hapur ekspozita e krijimeve, vepra të studentëve nga Instituti Ndërkombëtar i Modës “Izet Curri”. Në ekspozitën morën pjesë edhe ministrat e Arsimit dhe Shkencës dhe të Kulturës, Arbër Ademi dhe



Asaf Ademi.

“Më duhet të theksoj se mbrojtësit e Currit kanë bërë krijime të mrekullueshme e të denja për ekspozitë jo vetëm në Shkup, por edhe në djepin e modës - Parisin, vendi ku çdo krijues i ri ëndërron të punojë. Republika e Maqedonisë është vend i pasur me njerëz të rinj dhe të talentuar, të cilët kërkojnë mundësinë për të shfaqur kreativitetin e tyre; njerëz, të cilëve nëse u jepet mundësia, do të jenë në ballë të shtëpive botërore të modës”, tha ministri

Ademi në fjalimin e tij. Ministri Ademi u bëri thirrje studentëve t'i shprehin ëndrrat dhe pasionet e tyre përmes modeleve që ata i disejnojnë, por çdo fjalë e çdo sugjerim ta pranojnë qëllimshëm, sepse “mjeshtri” i tyre Curri është brend në botën e modës, emër që e njohin yjet më të mëdhenj. “Ju jeni trashëgimtarët e tij dhe ju duhet të justifikoni epitetin ‘nxënës i Currit’. Besoj se shumë prej jush ëndërronin të punonin për ndonjë nga shtëpitë e modës në botë; të jeni pjesë e javëve të mëdha të

modës në Paris, Milano, Romë. Ëndrra juaj mund të përmbushet vetëm nëse punoni me zell, nëse jeni 100% të përkushtuar në atë që ju plotëson dhe që e bëni me dashuri të madhe. Për të qenë i suksesshëm nuk do të thotë se duhet të larguar nga vendi, por për të qenë i suksesshëm do të thotë të qëndrosh në shtëpi me të dashurit, por e tërë bota të përmendë emrin tuaj dhe të magjepsen nga kreacionet që i ke krijuar”, ka shtuar Ademi. Para të pranishmëve fjalim mbajti edhe ministri i Kulturës. Ekspozita u organizua në nder të njërit nga kreatorëve më të mëdhenj të modës në shekullin 20, Azedin Alaja. Instituti francez në Shkup, si bashkëpunëtor i Institutit “Izet Curri”, ndau tre çmime për arritje dhe sukses të studentëve gjatë këtij viti. Në ngjarjen, përveç studentëve të shumtë dhe profesorëve, morën pjesë edhe disajnerët e Institutit Ndërkombëtar për modë Izet Curri, ambasadori francez në Maqedoni, Kristian Timonier, si dhe drejtori i Institutit francez në Shkup, Emanuel Rember. (MIA)

Vlera Çiçe, pasioni për tu bërë balerinë

Dibranët u ngajnë shpendëve shtegëtarë. Ata i gjen nëpër shumë vende të botës gjithnjë për një jetë më të mirë. Kudo që jetojnë e punojnë dëshmojnë kontribut dhe afinitet kulturor. Edhe në Shkup jetojnë një numër i madh i dibranëve të organizuar në Shoqatën „Votra dibrane”.

Lexuesve tanë do tua prezentojmë vogëlushen 11 vjeçare Vlera Çiçe, nxënëse e klasës së V në shkollën fillore „Hasan Prishtina” në Shkup. E veçanta e kësaj vogëlusheje është se e ndjekën edhe Shkollën shtetërore të muzikës dhe baletit „Ilija Nikolovski Iuj” po në Shkup në klasën e profesores Ilinka Nakova. Këtë shkollë të baletit Vlera e ndjek tashme katër vite çdo ditë të javës në orët e pasdites, duke shprehur një talent dhe afinitet të lartë. Kjo u deshmu edhe në Festivalin ndërkombëtar „X DAN-CE” të baletit për fëmijë, ku merrnin pjesë me dhjetëra grupe nga Maqedonia, Rusia, Ukraina, Italia, etj., që u mbajt në Shkup në muajin Qershor të vitit që shkoi dhe me 17-18 Qershor të këtij viti, në të cilin grupi ku merre pjesë Vlera zuri vendin e tretë radhazi në këtë konkurrencë të fortë. Si rezultat i kësaj u dekoruan me mirënjohje dhe me medalje përkatëse. Ky festival u ndoq nga një numër i madh spektatorësh. Profesoresha Ilinka Nakova për këtë balerinë të talentuar dibrane flet me fjalë miradie se në të ardhmen kjo vogëlushe do të arrin suksese edhe më të mëdha. Ndërkaq vogëlushja Vlera Çiçe u shpreh se ndjehet shumë e entuziasmuar për suksesin e arritur dhe se kur të rritet ka dëshirë që të merret edhe me pikturë. Kështu që si shprehet kjo vogëlushe me ritmin muzikor dhe me lëvizjet si balerinë do ta kënaq veten dhe publikun, ndërsa me pikturën do ta çlodhë mendjen dhe shpirtin e saj. (R.Torte)



Vjen në shqip romani erotik i Kostas Mourselasit

Është ky një roman psikologjik me skenë shoqërore të ngurtë dhe erotizëm të fortë. Një roman që ngjason me një pikturë të Hieronymus Boschit. Shkrimtari grek Kostas Mourselas lindi në Pire në janar të vitit 1932. Është diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Athinës. Deri në vitin 1969 punoi në administratën publike, nga ku u pushua prej qeverisë së Juntës Ushtarake. Përkrahje në këtë kohë filloi të shkruante pjesë teatrale dhe skenarë filmash televi-

zivë. Është autor i disa librave, si: “Oh, çfarë bote, baba!”, “Akvarium”, “Miqte”, “Zonja nuk mban zi”, “Veshi i Aleksandrit”, “Ngadalë, atdheu po pushon”, “Thika ka shkuar në kockë”, “Njerëz dhe kuaj”, “Ai dhe ai”, “Komedi kombëtare”, “Ngarkesë e rrezikshme”, “Flokë flakë të kuq”, “Mbyllur për shkak të melankolisë”, që patën një sukses të madh. Veç tyre shkroi edhe 130 monodrama. Veprat e tij teatrale janë vënë në skenë edhe në Francë, Gjermani dhe Qipro. Ro-

mani “Flokë flakë të kuq” qarkulloi për herë të parë në greqisht, më 1989 dhe u lexua nga mijëra e mijëra lexues duke e kthyer këtë roman në një nga më të suksesshmit e viteve 1980. Madje, pothuajse në të njëjtin vit, u realizua edhe seriali televiziv me të njëjtin titull. Në vazhdim u përkthye dhe u botua në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, hebraisht dhe turqisht. Shkrimtari Kostas Mourselas u nda nga jeta, më 15 korrik 2017, në moshën 85-vjeçare.



Një roman klasik karakteresh. Kështu shihet nga kritika romani “Flokë flakë të kuq” i shkrimtarit grek Kostas Mourselas. Libri ka ardhur në shqip nën përkthimin e Maklena Nikës te botimet “Toena”.

Robert Ndrenika përshëndet Teatri Kombëtar bashkëkohor

Pas deklaratës së kryebashkiakut Erion Veliaj se bashkia kishte arritur marrëveshjen me disa përfaqësues të artistëve, për ndërtimin e një godine të re të Teatrit Kombëtar, vjen reagimi nga Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit. Përmes një deklaratë zyrtare Aleanca bën me dije se deri më tani nuk ka asnjë kompromis dhe marrëveshje me asnjë përfaqësues qeveritar



jetë deri në ditën e përrurimit e më tej.

Përfaqfime!”.

Por, megjithatë, pas deklaratës së kryebashkiakut Erion Veliaj se bashkia kishte arritur marrëveshjen me disa përfaqësues të artistëve, për ndërtimin e një godine të re të Teatrit Kombëtar, vjen reagimi nga Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit.

Përmes një deklaratë zyrtare Aleanca bën me dije se deri më tani nuk ka asnjë kompromis dhe marrëveshje me asnjë përfaqësues qeveritar pa u tërhequr ligji i

Ikona e skenës teatrale dhe kinematografike shqiptare, Robert Ndrenika ka përshëndetur marrëveshjen e arritur në negociatat mes kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe përfaqësues të komunitetit të artistëve për ndërtimin e një Teatri të ri Kombëtar.

Nëpërmjet një mesazhi në Facebook, Ndrenika falënderon aktorët në këtë proces për rezultatin e arritur, ndërsa thekson që kjo frymë të shoqërojnë më tej të gjithë diskutimin për ndërtimin e një teatri bashkëkohor.

Më poshtë mesazhi i plotë i aktorit Robert Ndrenika:

“Të nderuar zotërinj Arben Derhemi, Altin Basha dhe Alfred Trebicka.

I nderuar Kryetar i Bashkisë zoti Erion Veliaj!

Personalisht ju falënderoj për rezultatin e arritur! Ju sot shënuat fillimin e një marathone që le të shpresojmë do të përfundojë me ndërtimin e një Teatri Kombëtar bashkëkohor. Uroj që fryma e sinqeritetit, transparencës dhe mirëkuptimit midis jush, si përfaqësues të komunitet teatror dhe Bashkisë, të

TARAVARI PRITI FUTBOLLISTIN ADMIR MEHMEDI

Para disa ditësh patëm nobelistin Ferid Murad, ndërsa sot kemi mysafir në Komunën tonë futbollistin me famë botërore, Admir Mehmedi. Na bën nder që është sot këtu me ne dhe shpresoj se karriera e tij e cila ka filluar patra dhjetë vite më parë, do të vazhdojë edhe dhjetë vite tjera, si në kombëtaren e Zvicrës, ashtu edhe në klubet futbollistike ku ai do të luajë, theksoi Taravari



Costivar - 28 qershor - Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, ka pritur dje në kabinetin e tij futbollistin e kombëtares së Zvicrës, me prejardhje nga Gostivari, Admir Mehmedi. "Njerëzit tanë të cilët jetojnë jashtë vendlindjes janë ambasadorët tanë më të mirë nëpër botë, sidomos ata të cilët shënojnë suksese në sferën e

shkencës, kulturës dhe sportit. Para disa ditësh patëm nobelistin Ferid Murad, ndërsa sot kemi mysafir në Komunën tonë futbollistin me famë botërore, Admir Mehmedi. Na bën nder që është sot këtu me ne dhe shpresoj se karriera e tij e cila ka filluar patra dhjetë vite më parë, do të vazhdojë edhe dhjetë vite tjera, si në kombëtaren e Zvicrës, ashtu edhe në klubet futbollistike

ku ai do të luajë, theksoi Taravari. Admir Mehmedi falënderoi kryetarin Taravari për mikpritjen dhe i dëshiroi atij sukses në qeverisje, duke uruar që Komuna e Gostivarit të ketë një zhvillim dhe përparim sa më të madh në të gjitha fushat. Në shenjë respekti ndaj njëri-tjetrit, Taravari dhe Mehmedi shkëmbyen dhurata simbolike. Mehmedi i dhuroi Taravarit fanel-

lën e kombëtares zvicerane me numrin 18, ndërsa Taravari Memedit i dhuroi pllakatën e Komunës së Gostivarit. Ndryshe, Mehmedi është futbollisti i parë shqiptar, i cili ka shënuar gol në Kampionat Botëror të futbollit. Shkaku i një operacionit të ligamentit, Mehmedi në këtë kampionat botëror nuk është pjesë e kombëtares së Zvicrës.

Zbulohet kombëtarja që mund të drejtojë De Biazi

Pak ditë më parë, ish-trajneri i kombëtares shqiptare, Xhiani de Biazi u shpreh se po pret përfundimin e Kupës së Botës, pasi ai do të marrë drejtimin e një skuadre që është pjesë e atij turneu. Në fillim u aludua për ndonjë skuadër të vogël, por në fakt e ardhmja e De Biazit duket se do të jetë në Poloni. Sipas "Tutto Mercato Web", trajneri aktual i Polonisë, Adam Naualka do të shkarkohet nga puna pas Botërorit, duke qenë se Polonia e sheh veten jashtë Kupës së Botës. Pasesues i tij në krye të stolit polak, pritet të jetë Xhani De Biazi, i cili më parë ka arritur të çojë Shqipërinë në Euro 2016, aty ku Shqipëria debutonte për herë të parë.

MIRAN MAKSUTI ARRIN MARRËVESHJE ME RENOVËN I lumtur që u riktheva, pres një sezon të mirë



Shkup, 28 qershor - Miran Maksuti, është futbollisti i ri i Renovës. Sulmuesi shtatlartë është marr vesh me drejtuesit e klubit bardhekaltër duke nënshkruar kontratë një vjeçare. Për gazetën KOHA, Maksuti tha se pas largimit nga Keku, ka pasur disa oferta nga klubet tjera kosovare, por pasi ka marr ofertë nga Renova, nuk është

menduar shumë. "Pas përfundimit të kontratës me KEK-un, kisha disa oferta serioze në Kosovë, por në ndërkohë drejtuesit e Renovës më ofruan kontratë serioze. Nuk mendova dy herë dhe vendosa të pranoj ofertën e tyre", u shpreh për KOHA, Maksuti. Ai thotë se është i lumtur që është rikthyer të luajë përsëri për Renovën. "Jam shumë i lumtur që do të rikthehem të luajë në Tetovë, respektivisht te Renova. Pres një sezon të mirë, me një trajner të ri me ambicie të mëdha siç është Jeton Beqiri", deklaroi Maksuti. Maksuti, në Tetovë vjen nga skuadra e Kekut, ndërsa për atë kjo është hera e dytë që do të vesh fanellën e Renovës, duke marr parasys se ishte pjesë e saj në vitin 2013. Ndryshe, gjatë karrierës së tij Maksuti ka luajtur edhe për skuadrën nga Danimarka Harlev, pastaj Llapin nga Kosova dhe FC Shkupin. Cekim, para disa dite, KF Renova emëroi në krye të stafit teknik Jeton Beqiri.

TRAJNERI KUKA FLET PAS PAS MEDALJEVE TË ARTA TË NORËS E DISTRISË

Në Spanjë dy herë u njoftuan me shtetin tonë të ri

E mërkura ishte dita e Kosovës, pasi i fitoi dy medaljet e para të arta në Lojërat Mesdhetare, në pjesëmarrjen e saj të parë në këtë event. Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi shkëlqyen në xhudo duke fituar medalje të artë në "Tarragona 2018". Ato i mposhtën kundërshtarët italianë dhe e bënë krenar vendin e tyre. Ndryshe, me këtë sukses trajneri Driton Kuka është ndër më lumtur dhe krenar me medaljet e arta që i fituan Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi. Këto njëherësh ishin dy medaljet e para në histori të sportit kosovar, pasi Kosova po merr pjesë për herë të parë



në një event të tillë. "Dy të arta! Lojërat Mesdhetare Disi e Nora na bënë krenar! Në shtetin e Spanjës dy herë u njoftuan me shtetin tonë të ri", ka shkruar Kuka në "Facebook". Ndërkohë, dje Akil Gjakova ka

kaluar në finale të xhudos për kategorinë deri në 73 kilogramë, duke mposhtur egjiptianin Mohamed Mohyeldin në gjysmëfinale, për t'ia siguruar Kosovës medaljen e tretë në Lojërat Mesdhetare.

Manaj pranë kalimit te Selta Vigo

E ardhmja e Rej Manaj mund të vazhdojë të jetë në Spanjë. Sulmuesi i kombëtares shqiptare pas eksperiencës në "Segunda Division" me skuadrën e Granadas në formë huazimi, kërkohet nga Selta Vigo dhe tashmë mund të luajë në La Liga. Klubi galician i ka ofruar 2 milionë euro Interit për kartonin e kuqezit me zikaltrit që kërkojnë ta shesin futbollistin përpara datës 30 qershor pasi me largimin e tij do të fitonin një plusvalencë të rëndësishme në bilanc në optikën e "fair-play financiar". Manaj nga ana tjetër është i gatshëm ta pranojë ofertën. Për shqiptarin interesohen edhe disa klube portugeze, ndërsa pëlqehet edhe në Itali.



FABREGAS KËSHILLON SHOKUN E SKUADRËS EDEN HAZARD

MOS SHKO TE REALI DHE BËHU LEGJENDË TE ÇELLSI

“Eden Hazard ka cilësitë që të jetë më i miri, sidomos tani që Cristiano Ronaldo dhe Leo Messi po “plaken”. Ai mund të jetë, gjithashtu, një legjendë e klubit të Çellsit, nëse qëndron. Gjithçka që unë i them atij është të qëndrojë, sepse te Çellsit do të jetë ‘violinë e parë’, tha për “The Telegraph” Fabregas

Eden Hazard është nxitur nga shoku i skuadrës te Çellsit, Cesc Fabregas, për ta shmangur interesin e Real Madridit dhe për t'u bërë një legjendë e klubit nga “Stamford Bridge”. Zërat për transferim të ndërkombëtarit belg nuk janë asgjë e re, me të ardhmen e tij të vënë në dyshim për njëfarë kohe. Spekulumet, megjithatë, janë ndërtuar përsëri gjatë javëve të fundit, me 27-vjeçarin duke bërë pak për të frenuar thashethemet. Fabregas shpreson se një sagë e tillë e gjatë do të mbyllet përfundimisht e do të jetë e dobishme për Çellsin, me qëndrimin e belgut, i cili ka ende shumë për të arritur në perëndim të Londrës. “Eden Hazard ka cilësitë që të jetë më i miri, sidomos tani që Cristiano Ronaldo dhe Leo Messi po “plaken”. Ai mund të jetë, gjithashtu, një legjendë e klubit të Çellsit,



nëse qëndron. Gjithçka që unë i them atij është të qëndrojë, sepse te Çellsit do të jetë ‘violinë e parë’, tha për “The Telegraph” Fabregas. “Ai ka të gjitha atributet dhe është ende në moshën, kur mund të jetë më i miri, kaluar Neymar dhe ndoshta Mbappe. Talenti është në këmbët e tij, nuk kam asnjë dyshim për këtë. Ai është i fortë, i shpejtë, mund të driblojë këdo. Mendoj se Edeni mund të shënojë më shumë gola. Unë besoj në të më shumë se vetë ai”, vazhdoi më tej Fabregas. “Kupa e Botës nuk do të vendosë të ardhmen e Ede-

nit, nuk mendoj. Skautët i ndjekin talentet kudo, por ai ka bërë më shumë se sa duhet për klubet u ka luajtur, të gjithë e njohin mirë talentin e tij. Me të vërtetë shpresoj se ai mund të qëndrojë te Çellsit për shumë vite dhe të bëhet një nga legjendat më të mëdha në historinë e klubit. I ka të gjitha atributet dhe e vetmja gjë që i mungon është Liga e Kampionëve. Nëse qëndron, jam i sigurt se ai do të jetë, nëse jo më i miri, një nga lojtarët më të mirë që Çellsit ka pasur ndonjëherë dhe do të ketë”, përfundoi mesfushori spanjoll.

Barcelona s'heq dorë nga Pjaniçi

Barcelona nuk heq dorë nga pista që e çon te Miralem Pjaniçi. Juventusit ndërkohë kërkon të përfitojë nga situata duke e rritur në 100 milionë euro çmimin e futbollistit boshnjak, ose 85 milionë euro, plus bonuset. Katalanët kanë nevojë për një tjetër mesfushor fantazist pas largimit të Andres Iniestës dhe mes dy alternativa kryesore, Eriksen dhe Pjaniçi, trajneri Valverde ka preferuar ballkanasin. Barcelona mësohet se ka arritur marrëveshjen me futbollistin për 7 milionë euro në sezon. “Blaugranat” shpresojnë që të mos jetë një telenovelë pa një fund të lumtur, siç ndodhi me Marko Verratin, që nuk u shit nga PSZH. Menaxheri i Pjaniçi, Mihael Beker, deklaroi për “El Mundo Deportivo” se: “Interesi i Barcelonës është intrigues, por gjithçka varet nga Juventusit”. Dhe është pikërisht kështu. Bardhezinjtë nuk mbajnë asnjë futbollist pa dëshirë, por sigurisht nuk do ta lejojnë largimin e mesfushorit pa e vlerësuar si duhet kartonin e tij. Me pak fjalë, pa 90 milionë euro Marotta nuk pranon as të ulet në tavolinën e bisedimeve.



MILANI SURPRIZON

Transferon talentin kroat Halilović

Milani po kalon një moment të vështirë sa i përket dënimin nga UEFA dhe çështjes së pronësisë së klubit. Por, “Djalli” ka bërë surprizën duke bërë një lëvizje të shpejtë dhe pa shumë bujë, në Milano ka mbërritur Alen Halilović. Mesfushori me tipare sulmuese konsiderohet një talent më të ardhme të ndritur për faktin se është 22 vjeç dhe ka luajtur në nivele të larta futbollit. Halilović dje ka kryer vizitat mjekësore në Milano, dhe pritej të firmosë kontratën 3-vjeçare me Milanin. Cekim, Halilović ka dalë nga academia e Dinamo Zagrebit, ndërsa karrierën e vijoi në Gjer-



mani te Augsburg. Sezonin që lamë pas ai ka vuajtur nga një dëmtim në kavigje që e ka lënë gjatë jashtë fushe.

Super-ofertë nga Çellsit për Ruganin

Çellsit ka paraqitur një super ofertë në dyert e Juventusit. 40 milionë euro për të lënë të lirë mbrojtësin Daniele Rugani. Blutë e Londrës kërkojnë të presin teknkun e tyre të ri, Maurizio Sarri pikërisht me këtë blerje edhe pse zyrtarizimi ende nuk ka ardhur, një gjë e tillë pritet të ndodhë në fundjavë. Por sipas asaj që shkruajnë mediat britanike Rugani është një kërkesë e vetë teknikut Sarri. Deri më tani bardhezinjtë janë shfaqur të palëkundur pavarësisht çdo lloj oferte që ka ardhur në drejtim të 23-vjeçarit, por duket se këtë herë situata është disi më ndryshe. 40 milionë euro është një shifër tepër e lartë dhe që drejtuesit e zonjës së vjetër mund ta shfrytëzojnë për të përforcuar ekipin më ndonjë element tjetër cilësor. Në ditët në vazh-



dim pritet të ketë edhe një takim mes palëve për të arritur tek akordi. Ndërkohë që për Daniele Ruganin është gati një kontratë e majme nga e cila do të përfitojë 5 milionë euro në sezon, dyfishin e asaj që merr tek Juventusit.

LAJME SHKURT

Azpilikueta mes Anglisë dhe Spanjës

Mediat spanjolle shkruajnë se mbrojtësi i Çellsit, Cesar Azpilikueta, dëshiron të rikthehet në La Liga. Për 28-vjeçarin ka shprehur interes skuadra e Atletik Bilbao, e cila është e gatshme të ofrojë deri në 20 milionë euro për mbrojtësin e djathtë. Prej 6 sezonesh Azpilikueta luan për blutë, të cilët e blenë te Marsej, ndërkohë që vitet e fundit ai ka qenë një titullar i padiskutueshëm në formacionin e bluve. Ende nuk dihet se cili do të jetë vendimi i klubit për të ardhmen e tij, ndërsa sipas të njëjtave burimeve, Çellsit do ta linte Azpilikueta të largohej nëse ata i sigurojnë shërbimet e Zhoao Mirandës nga Interi.

Elyounoussi te Totenhami për 18 mln euro

Sautemptoni e ka gjetur menjëherë zëvendësuesin e Dushan Tadiç, i cili sezonin e ardhshëm do të luajë me holandezët e Ajaksit. Anglezët kanë arritur akordin me zviceranët e Bazelit për të transferuar Mohamed Elyounoussi për 18 milionë euro. 23-vjeçari shënoi plot 14 gola në 45 paraqitje gjatë sezonit të kaluar. Elyounoussi është një futbollist, i cili mund të luajë si në rolin e sulmuesit, po ashtu edhe në rolin e mesfushorit të avancuar, ndërsa ai ka regjistruar edhe 16 paraqitje me kombëtaren e Norvegjisë.

Gabi i bashkohet Çavit në Katar

Kapiteni i Atletikos së Madridit, Gabi do të largohet nga kryeqyteti spanjoll, për të vijuar karrierën e tij në Katar, ku do të firmosë me skuadrën e Al Sadd. Në këtë ekip aktivizohet edhe ish mesfushori legjendar i Spanjës dhe Barcelonës, Çavi Hernandez, ndërsa Gabi do të luajë aty për 3 sezone dhe do të përfitojë 19 milionë euro. Gabi ka luajtur 417 ndeshje zyrtare me Atletiko Madrid, duke shënuar 10 gola e duke fituar 6 tituj: një kampionat spanjoll, një Kupë Mbreti, një Superkupë Spanje, dy “Europa League” dhe një Superkupë Evrope.

Valencia i “vjedh” talentin Lionit!

Valencia është pranë arritjes së marrëveshjes me Lionin për mbrojtësin Mouktar Diakhaby. Sipas shtypit spanjoll, akordi pritet të mbyllet për një shifër prej 15 milionë euro. 21-vjeçari, me origjinë nga Guineja, është pjesë e skuadrës së parë të Lionit që nga shtatori i vitit 2016, ndërkohë që ka luajtur edhe 8 takime me kombëtaren U-21 të Francës. Ai është ndjekur nga afër edhe nga anglezët e Sautemptonit, ndërkohë që në sezonin e fundit nuk ka luajtur rregullisht për shkak të dëmtimeve.

"Edhe sikur të kishim kaluar në 1/8 finale, gjithkush do të donte të luante kundër nesh në këtë Botëror. Si mund të jemi të rrezikshëm për një kundërshtar, nëse japim shfaqje të tilla? Gjithmonë u përpoqa të merrja përgjegjësinë, gjithmonë u përpoqa të karikoj ekipin në dhomat e zhveshjeve, gjatë trajnimit dhe në fushë. Sigurisht, unë jam gjithashtu përgjegjës për këtë zhgënjim", deklaroi Nojer

Manuel Nojer beson se do të ishte "e hidhur dhe patetike" për lojtarët e Gjermanisë, që të kënaqen me lavditë e tyre të kaluara në vazhden e paraqitjes së tyre të tmerrshme në Botërorin e Rusisë. Kampionët botërorë në fuqi e humbën këtë mundësi të mërkurën për ta mbrojtur kuroren, pasi Koreja e Jugut i mundi 2-0 në Kazan, duke i dhënë Gjermanisë vendin e fundit në Grupit F. Ndërsa, ekipi i Joakim Lev e fitoi trofeun në "Brazil 2014", ai u bashkua me Spanjën, Italinë dhe Francën, në listën e ekipeve kampione, që janë eliminuar që në fazën e grupit në

SHPËRTHEN KAPITENI MANUEL NOJER

KËSAJ GJERMANIE NUK I TREMBEJ KUSH, MADJE AS E RESPEKTONIN



edicionin pasardhës. Dhe Nojer, i cili u kthye nga lëndimi i gjatë në kohë për të bërë kapitenin e Gjermanisë në këtë Kupën e Botës, këmbëngul që "Die Mannschaft" nuk mund të justifikohet dhe kënaqet me arritjet e kaluara. "Ne e kishim gjithçka në duart tona, por nuk e bëmë, - tha Nojer, i cili konfirmoi qëllimin e tij për të qëndruar në dispozicion të kombëtares. "Të kënaqemi me të kaluarën nuk na sjell asgjë, kjo është e hidhur dhe patetike. Të eliminoeshim që në grupe, thjesht nuk e meritonim. Ne

nuk kemi bindur realisht në asnjë ndeshje. Natyrisht që kjo është shumë zhgënjyese. Kemi nevojë për ta analizuar këtë që ndodhi dhe duhet të thuhet shumë qartë se thjesht nuk e meritojmë. Edhe pas tri lojërave në këtë Botëror, ju nuk keni parë ekipin gjerman në fushë, para së cilit kundërshtari ka frikë, ose respekt. Edhe sikur të kishim kaluar në 1/8 finale, gjithkush do të donte të luante kundër nesh në këtë Botëror. Si mund të jemi të rrezikshëm për një kundërshtar, nëse japim shfaqje të tilla? Gjithmonë

u përpoqa të merrja përgjegjësinë, gjithmonë u përpoqa të karikoj ekipin në dhomat e zhveshjeve, gjatë trajnimit dhe në fushë. Sigurisht, unë jam gjithashtu përgjegjës për këtë zhgënjim", deklaroi Nojer.

E ARDHMJA E LEV NË DYSHIM

Joakim Lev është duke menduar seriozisht për të ardhmen e tij, pasi kampionët në fuqi të botës u shkurorëzuan shumë shpejt, duke u eliminuar që në fazën e grupeve pas humbjes 2-0 me Korenë e

Jugut. "Lev nënshkroi zgjatjen e kontratës deri në vitin 2022 gjatë majit, por refuzoi të konfirmonte qëndrimin e tij në krye të "pancervere" edhe gjatë fushatës për kualifikueset e Evropianit të ardhshëm. "Është shumë herët për mua t'i përgjigjem kësaj pyetjeje, - tha ai. Na duhen disa orë të paktën për të qartësuar gjërat. Zhgënjimi është i thellë, brenda meje, lojtarëve dhe tifozëve. Nuk mund ta kisha imagjinuar se do të mund të humbnim ndaj Koresë së Jugut. Jam i tronditur, sepse nuk dhamë maksimumin sot. Do të ishte e parakohshme për mua të thosha diçka, sepse jam thellësisht i zhgënjyer. Sa larg mund të shkojmë nga ky moment e në vijim? Na duhet kohë dhe bisedime me qetësi për gjithçka", deklaroi Lev.

REAGON MERKEL

Eliminimi i Gjermanisë nga kampionati botëror "Rusi 2018" ishte një befasi për të gjithë, trishtimi është i dukshëm natyrisht, por ka qenë kancelarja Angela Merkel, ajo që ka tentuar të ngrejë disi moralin për skuadrën, por edhe popullin gjerman. "Nuk ishte Botërori ynë. Çfarë trishtimi! Gjithsesi do të vijmë kompeticione të tjera, ku do të festojmë", shkroi kancelarja Merkel në "Twitter", duke nxjerrë në pah shpirtin tipik gjerman, trishtimin për dështimin dhe dëshirën për t'u rinisur menjëherë.

Publicitet

OFERTA QË I KA TË GJITHA!

- Çmime atraktive dhe kushte të volitshme për pagesë.
- Sasi të kufizuara, që do ti merrni menjëherë
- Akcioni zgjat deri me datë 30.06.2018. Nxitoni!



Aventurë verore me SUV ose me SEDAN?
Zgjidhja është e juaja.

Crossland X Enjoy 1.2 benzinë, tanimë

169€ kësti mujor

Astra Sedan Enjoy 1.6 benzinë, tanimë

139€ kësti mujor

opel.mk



E ARDHMJA I TAKON TË GJITHËVE

Crossland X Enjoy 1.2 benzinë. Çmimi: 14.620€ me pjesëmarrje prej 30% ose 4.390€ dhe kësti prej 169€ për periudhë prej 72 muajsh. Astra Sedan Enjoy 1.6 benzinë. Çmimi 13.200€ me pjesëmarrje prej 35% ose 4.620€ dhe kësti prej 139€ për periudhë prej 72 muajsh. Përlogaritja ka të bëjë me pagesë të lizingut financiar në bashkëpunim me „Sparkasse Lizing“, për 72 muajsh. Pamja e paraqitur e veturës është vetëm për ilustrim dhe nuk ka të bëjë me këtë promovim. Opel Southeast Europe LLC dhe liderët e autorizuar e mbajnë të drejtën e ndryshimit dhe tërheqjes së ofertës në çfarëdo kohe dhe pa paralajmërim paraprak. Për më tepër informacion kontaktoni liderët e autorizuar të Opel-it. Oferta vlen deri me datë 30.06.2018.

Automakedonija 02 310 31 30

Auto CEM 044 353 330

DASHI 21. mars - 20. prill
Do të jeni mjaft të përkushtuar në realizimin e marrëveshjeve të reja, të cilat prej shumë javësh ju kanë shqetësuar. Mos i vendosni vetes asnjë limit, por propozoni strategji alternative.

DEMI 21. prill - 21. maj
Kjo është një ditë e cila do ju gjejë mjaft të zënë me punë. Do të jeni të detyruar që të rishikoni disa projekte tuaja dhe të riorganizoni totalisht planin tuaj të veprimit. Në dashuri këshillohet që të mos jeni shumë impulsiv.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Po përballemi një rrugëtim, i cili do ju çojë në një rritje të rëndësishme si nga pikëpamja profesionale edhe ajo sentimentale. Disa zgjedhje tuaja do të jenë vendimtare për realizimin me sukses të një projekti të ri.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Duhet të jeni të kujdesshëm dhe të përqendruar në vendin tuaj të punës, pasi ky është momenti më i mirë për të rimarrë në dorë të gjithë projektet që keni lënë pas dore prej kohësh. Tregohuni të kujdesshëm në raportet ndërpersonale, pasi një keqkuptim i vogël, mund të kthehet në një problem të madh.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Kjo e enjte do të jetë mjaft interesante për të ndryshuar të gjitha aspektet e rutinës tuaj, të cilat nuk ju kënaqin aspak. Kjo ditë ju fton të jeni më të kthjellët dhe të lini mënjanë të gjitha tensionet e kota, të cilat në vendin e punës do të kenë ndikim negativ në zhvillimin e aktiviteteve tuaja.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Dita do të jetë mjaft e favorshme për dashurinë, ku më në fund do të keni mundësi që të zyrtarizoni një histori dashurie dhe do mund të vendosni objektivat në çift. Këshillohet që të mos jeni shumë autoritar dhe të lejoni që partneri/ja juaj të shpreh mendimin siç e gjykon.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Nuk duhet të jeni shumë xheloz ndaj partnerit/es, pasi tensionet e periudhës së fundit mund të ushqejnë mosmarrëveshje në çift. Propozimet e mira duhet të vlerësohen me më shumë kujdes, sidomos kur sjellin ndryshime të mëdha.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Kjo ditë do të jetë mjaft e rëndësishme për të mbyllur përfundimisht raportet nervoze dhe që ju bëjnë të palumtur. Është e rëndësishme që të rigjeni qetësinë, kështu që mundohuni të rrethoheni nga njerëz pozitiv, të cilët janë të gatshëm që t'iu dëgjojnë. E enjta favorizon projektet e reja.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Në këtë moment konfuzioni, është e rëndësishme që të mos merrni vendime të nxituara në dashuri, për shkak se mund të shkojnë kundër ndjenjave tuaja të vërteta. Duhet të jeni të sqartë me veten dhe me personin që pëlqeni. Parashikohen mundësi shumë të mira për të çuar përpara propozime të reja në vendin e punës.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Gjatë kësaj dite do të keni mundësi që të shprehni hapur krijimtarinë tuaj si dhe të merrni rezultate të mëdha. Mos lini pas dore raportet ndërpersonale, pasi në këtë moment është e rëndësishme që të rivendosni harmoninë dhe qetësinë në raportet tuaja.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Yjet ju sugjerojnë që të jeni më kurajoz dhe të shprehni pa mëdyshje të gjitha dëshirat dhe nevojat tuaja, si në familje edhe në dashuri. Tregohuni të matur me projektet që nuk janë shumë urgjente.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Ky është një moment shumë i mirë për të kapërcyer një fazë të rënies emocionale. Do të bëni ballafaqimin e duhur me partnerin, por edhe me familjen dhe kolegët. Nga pikëpamja profesionale do të merrni përgjigje të rëndësishme.

Mensur Mamuti	TË NDALUARA ME FE (SH. PASHQ.) QYTETI I LINDJES SË FUTBOLLISTIT NË FOTO	H	KËNGËTARJA PARAVELI	KLUBI I PARË I FUTBOLLISTIT NË FOTO	ONLINE NEWS ASSOCIATION
FILM I STALLONES					
NJË YJESI					
POLITIKANI ROM, IBRAIMOVSKI MORR BLETËSH					
V					PERSONAZH NGA 1001 NETË
MBYLLËSJA E DERËS					
IMPULSI		ARCTIC UMIAQ LINE KLUB SPANJOLL			
OA			NIKELI BANORI I SHBA-VE		
KOHA	SKULTORJI GJERMAN, VOLFGANG EKIPI AKTUAL I FUTBOLLIT NË FOTO				
SHTET NË OCEANIN E QETE				HËNË (TUR.)	NATRIUMI E SHOSHIT KËNGËTARI YNË, SELIMI LËSHIMI I AEROPLANIT NË TOKE
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS NË FOTO					
BANORËT E NJË QYTETI FRANCEZ					
QYTET HISTORIK NË AZI TË VOGËL			PËRGËZON	LUMË NË KOSOVË	DË IN-THE-EAR FRONI I ALLAHUT
LIKUIDUES					
JODI JANAR		BANOR I ARBERISË LL R			PËREMËR VETOR ASTATI
K					FUQI E TËRHEQJES APO FASCINIMIT TË NJERËZVE TEMPERATURA
KOHA	NDEZJE E HUNDËS				INTENSITETI



ZGJIDHJET: H, RAMBO, ORION, SAMKA, VAROA, REZJA, I AUL, OA, NI, LAIB, SAMOA, EVER BANEGA, VERSAJASET, ISI, IFE, LIKUIDATOR, J, ARBER, AI, KALLNOR, SHARM, RINITIS, I,

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

						2				4			6			2	
		6	4						3					4			5
4						5		1		9			7		1		
		9	6						7	1	3	2			4	5	9
	7		3					1				1		7			
		4	5			9			5					9			2
						1	8	6			9		4			6	
	5			9	4				6					3			4
					6			7		3			9			7	

Shumë i lehtë: 895163724, 716425398, 423987561, 539618247, 278349615, 164572983, 942731856, 657894132, 381256479. Mesatar: 845361927, 371924685, 296875143, 713286459, 924157836, 568439712, 159742368, 687513294, 432698571.

Mjekët e lodhur veprojnë sikur të dehurit!

Mjekët e lodhur veprojnë të njëjtën mënyrë sikurse ata të ishin të dehur gjë që po rrezikon jetën e pacientëve, thotë një paralajmërim i ri. Ata që punojnë mbi 12 orë kanë të njëjtin përqendrim dhe gjykim si dikush që është i zhgënjyer e më pas dëfretet me pije alkoolike, thotë hulumtimi në Salisbury. Dr. Satish Jayagopal, një kirurg nga Salisbury, tha se profesioni-

stët shëndetësorë që punojnë këto ndërrime kanë më shumë se një të katërtën (27 për qind) gjasa që të bëjnë një gabim sesa ata që punojnë tetë orë. Në mënyrë të ngjashme, një studim mbi infermieret zbuloi se gabimet u trefishuan kur ndërrime rriteshin nga tetë deri në 12 orë, sipas një mocioni të paraqitur në konferencën e Shoqatës Mjekësore Britanike. Ai tha se hulumtimi kishte gjetur se ata që kryenin punë në kushte të tilla nuk kishin idenë se aftësitë e tyre ishin të dëmtuara dhe jo efektive për të kontrolluar një pacient.



Rita anulon koncertin në Izrael

Këngëtarja me prejardhje shqiptare, Rita Ora, ka anuluar pjesëmarrjen e saj në festivalin muzikor "Wow" që do të mbahej në Rishon Lezion. Sipas drejtuesve të koncertit, Rita ka informuar kompaninë organizative se do të mungojë në koncert për shkak të problemeve shëndetësore. Mediat në Jerusalem raportojnë se ajo i ka thënë "Bluestone Group" se i duhet të bëjë një operacion shkak të problemeve shëndetësore, transmeton Koha.net. Krijuesja e hitit "Girls" do të performonte më 1 gusht përkrah këngëtarit Jason Derulo. Edhe pse e ka anuluar koncertin në Izrael, Rita pritet të performojë në Britani të Madhe më 28 korrik dhe në Lituani më 3 gusht. Gjatë muajit maj, Rita Ora anuloi një koncert në Bristol për shkak të problemeve shëndetësore.

SHBA vendi i 10-të më i rrezikshëm në botë për gratë



Shtetet e Bashkuara janë renditur për herë të parë në mesin e 10 vendeve që konsiderohen si më të rrezikshmet për gratë nga ekspertët në terren. Një sondazh i Fondacionit Thomson Reuters prej rreth 550 ekspertësh në çështjet e grave anembanë globit etiketon Shtetet e Bashkuara si vendi i 10-të më i rrezikshëm në lidhje me rrezikun e dhunës seksuale, si dhe ngacmimit seksual. Fondacioni tha se vendosja e SHBA në listën e dyshimtë ishte poshtë kryesisht në fushatat #MeToo dhe Time's Up, duke rritur

ndërgjegjësimin për dhunën seksuale dhe kërcënimin e grave në SHBA, pas akuzave kriminale kundër Harvey Weinstein. "Njerëzit duan që të mendojnë se të ardhurat e mira do të thonë se janë të mbrojtura nga keqtrajtimi, por fatqësisht nuk është kështu", tha fondacioni Cindy Southworth, i Rrjetit Kombëtar në Uashington për t'i dhënë fund dhunës në familje. "Ne do të shikojmë prapa dhe e shohim këtë si një pikë shumë të fuqishme kthese ... Ne po hedhim në kapak dhe po themi '# MeToo dhe Time's Up.'"

Stafi i administratës Trump kanë problem të gjejnë dashurinë!



Stafi i ri i administratës Trump po kanë probleme që të krijojnë lidhje romantike në Washington, një nga vendet me më së shumti demokratë. Shpesh refuzohen nëpër faqe online për takime kur dikush kupton se punojnë apo kanë votuar për presidentin Donald Trump. "Bëni disa bisedime të thjeshta dhe pastaj vjen pyetja "ke votuar për

Trump?!". Sapo pranoj që kam votuar për te marr ndonjë reagim si "si mund të jesh kaq raciste" dhe kritika të tjera" ka treguar një 30 vjeçare, punonjëse në Shtëpinë e Bardhë. Një përqindje e madhe e stafit tani janë në lidhje me njeri-tjetrin. Megjithatë si pjesë e Shtëpisë së Bardhë stafi mbajnë një paraqitje të duhur sociale.

1149 - Rajmondi i Antiokut mundet dhe vritet në Betejën e Inabit nga Nur-edini.

1194 - Sverr kurorëzohet si mbret i Norvegjisë.

1428 - Jakoba e Bavarisë nënshkruan armëpushim me Filipin e Mirë.

1529 - Perandori Karli V dhe Papa Klimenti VII nënshkruajnë Traktatin e Barcelonës.

1540 - Ish kancelari anglez Tomas Kromuell dënohet si heretik.

1613 - Shakespeare's Globe Theater burns doën

1659 - Rusët e udhëhequr nga Princi Trubeckoj mundën nga armata ukrainase e Ivan Vjovskit në Betejën e Konotopit.

1762 - Cari i Rusisë Pjetri III shkuroëzohet nga gruaja e tij Katerina II.

1822 - Princi Çarls Binapart martohet me kushërirën e tij Zenaide Bonapart.

1913 - Fillon Lufta e Dytë Ballkanike-Bullgaria mund trupat greko-serbe.

1914 - Xhina Guseva tenton të vret Grigori Rasputinin në Siberi.

1916 - Aeroplan i Boingut fluturon për herë të parë.

1949 - Afrika e Jugut fillon implementimin e aparteidit: ndalohen martesat e përziera.

1949 - Trupat amerikane tërhiqen nga Korea pas Luftës së Dytë Botërore.

1967 - Izraeli largon barrikatadat duke ribashkuar Jerusalemin.

2008 - Tomas Biti, mashkulli i parë shtatzënë lind vajzë.



Hieroglifet janë shkrimet e shenja egjiptiane. Këto shkrime janë ushqim shpirtëror dhe kulturor i Egjiptit. Karakteristikë e këtyre shkrimeve është se shkruhen nga 3 persona. Personi i 1 shkruante nga e djathta në të majtë, Personi i dytë shkruante nga e majta në të djathtë shkrimet. Ndërsa personi i tretë luante rolin e mbikëqyrës në punën e dy personave të parë. Ndryshe, akoma ka dyshime dhe hulumtimeve rreth deshifrimit të tyre.

THYERJA E DUARVE

Rregulli i parë: Asnjëherë mos i thyej duart me një mashkull që nuk ka të dashur për gjashtë muaj!



E kam ofenduar zotin dhe njerëzimin sepse puna ime nuk arriti kualitetin që duhet të kishte.

(Leonardo Da Vinci)



KALENDARI HISTORIK 29 QERSHOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS